



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
_____.2021

Tiranë, më

VENDIM
Nr. 273, datë 01.07.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIU DHËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatores znj. Brunilda Kadi,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...} për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR




KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E
GJYQTARES {...}



POLI I DREJTËSISË
RRUGA “ANA KOMNENA”
TIRANË

.

TË DHËNAT E GJYQTARIT

Emri: {...}

Mbiemri: {...}

Datëlindja: 08.11.1984

Vendbanimi: Fier

Adresa e e-mailit zyrtar: {...}. {...}@gjkata.gov.al

Adresa e e-mailit privat: igibregu@yahoo.com

Numër telefoni: +355 69 63 77 733

Gjykata: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier

Funksioni: Gjyqtare

Dhoma/Seksioni : Nuk ka

Vlerësimi i mëparshëm : Nuk ka

Masa Disiplinore : Nuk ka

Periudha e vlerësimit : Tetor 2013 - Tetor 2016 (gradim)

VLERËSUES

Relator: **Brunilda Kadi**

Nëpunësi përgjegjës për vlerësimin: **Zeta Tërpollari**

QËLLIMI

Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit që ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

⋮

Gjyqtari vlerësohet në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale të tij, me qëllim përcaktimin e shkallës së aftësisë së tij, e cila nuk mund të jetë e nivelit “pamjaftueshëm”, pasi gjyqtari është vlerësuar “i aftë” nga organet e rivlerësimit kalimtar. Në projektraport pasqyrohet sipas rendit kronologjik i gjithë procesit vlerësues të gradimit të gjyqtarit, sipas hapave: shkallë aftësie – pikëzim - nivel vlerësimi. Ky i fundit përcaktohet më vete për secilin nga katër kriteret e vlerësimit, bashkë me nivelin e përgjithshëm të vlerësimit për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Raporti i vlerësimit është hartuar bazuar në nenet 68, 89 e vijues, në nenin 171, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.263, datë 21.11.2019, “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, si dhe në Vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010, “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”.

Burimet e vlerësimit në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën vlerësimit 2013-2016, analizohen duke mbajtur parasysh: Përcaktimet e nenit 171, pika 5, të Ligjit për Statusin, në të cilin parashikohet se: *“5.Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës”*. Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Shkalla e kësaj aftësie në nivelet: “shkëlqyeshëm”, “shumë mirë”, “mirë” apo “mjaftueshëm”, përcaktohet në procesin e gradimit, pavarësisht konkluzioneve të organeve të vlerësimit lidhur me të.

PROCEDURA

1. Procedura e vlerësimit të gjyqtares {...}, ka filluar me vendimin nr. 75, datë 04.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas dërgimit të dosjeve me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit: Relator znj. Brunilda Kadi; Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Zeta Tërpollari.

2. Në datën 05.03.2021, në bazë të neneve 85 dhe 89 të Ligjit për Statusin dhe nenit 12 të Vendimit të KLGJ nr. 263, datë 21.11.2019, “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, gjyqtarja është njoftuar nëpërmjet postës elektronike, për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre, ose të çdo anëtar të Këshillit. Brenda

afatit 3 ditor, në datën 08.03.2021, gjyqtarja {...} ka konfirmuar marrjen e njoftimit nëpërmjet postës elektronike, duke deklaruar se është dakord me vlerësuesit dhe nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e tyre, ose të ndonjë anëtari të Këshillit.

3. Me procesverbalin e datës 30.03.2021, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, bazuar në pikën 24 të vendimit nr. 197, datë 11.06.2020, “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, ka evidentuar çështjet dhe vendimet që janë administruar në dosjen e rivlerësimit të cilat i përkasin periudhës së vlerësimit.

4. Me urdhrin e datës 08.04.2021, relatori ka disponuar për zhvillimin e shortit, përcaktimin e kategorisë së çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit për periudhën e vlerësimit 2013-2016, duke përcaktuar edhe datën e zhvillimit të shortit. Urdhri i është njoftuar gjyqtares, kryetares dhe kancelares të gjykatës në datën 09.04.2021, nëpërmjet postës elektronike.

5. Bazuar në urdhrin e relatorit, në datën 14.04.2021, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier është zhvilluar në mënyrë elektronike shorti për përzgjedhjen e 6 (gjashtë) çështjeve për vlerësim, i dokumentuar në procesverbalin përkatës.

6. Pas zhvillimit të shortit, më datë 28.04.2021, me nr. 1499/2 prot, janë protokolluar në KLGJ 3 (tre) dosjet e çështjeve të përzgjedhura me short, të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me shkresën me nr. 2135/1 Prot., datë 23.04.2021. Më datë 10.05.2021, me shkresën nr. 1499/4 prot, është protokolluar në KLGJ 1 (një) dosje e çështjeve të përzgjedhura me short, të dërguara nga Gjykata Administrative Vlorë me shkresën nr. 240/1 prot, datë 04.05.2021. Më datë 05.05.2021, nëpërmjet shkresës nr. 1499/3 prot, janë protokolluar 2 (dy) dosjet e fundit e çështjeve të përzgjedhura me short, të dërguara nga Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 1429/1 prot, datë 05.05.2021.

7. Pas administrimit të 6 (gjashtë) dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, ka filluar hartimi i projektraportit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...} për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

8. Me vendimin e datës 31.05.2021, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (KVEVP), pasi gjeti të plotë dokumentacionin e dosjes së vlerësimit, vendosi vijimin e procedurës së vlerësimit, me njoftimin e projektraportit të vlerësimit me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjyqtares {...}.

9. Projektraporti i vlerësimit u shqyrtua dhe u miratua, pa ndryshime, nga Këshilli në Mbledhjen Plenare të datës 01.07.2021.

⋮

BURIMET E VLERËSIMIT DHE EVIDENTIMI I TË DHËNAVE QË REZULTOJNË PREJ TYRE

Në këtë pjesë të raportit të vlerësimit gjenden të listuara burimet e vlerësimit, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur dhe vetëm për aq sa është e nevojshme për këtë proces vlerësimi, të dhënat që rezultojnë nga aktet e dokumentet e përdorura në procesin e rivlerësimit kalimtar, si dhe ato të marra rishtazi. Raporti i analizimit të aftësive profesionale të gjyqtarit, i përgatitur nga organi kompetent në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, duke qenë një akt që përshkruan të dhënat e burimeve të vlerësimit dhe analizon gjetjet që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre, konsiderohet për efekt gradimi i barazvlershëm me raportin analitik, vetëm për burimet në të cilat ai referon.

Burimet e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit Tetor 2013-Tetor 2016, e cila përkon me periudhën e vlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, në bazë të Ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenet 171, pika 5, dhe 77 të Ligjit Për statusin, përbëhen nga dy grupe:

Grupi I : Aktet e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit që janë pjesë e dosjes së rivlerësimit, si më poshtë:

1. Formulari i vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, i cili administrohet në dosjen e rivlerësimit,¹ është përshkruar dhe analizuar në mënyrë të plotë si burim vlerësimi në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit {...} me nr. 312 Prot., datë 24.01.2017.

2. Të dhënat e dosjes personale të gjyqtarit, e cila është administruar gjatë përgatitjes së Raportit për analizimin e aftësive profesionale me nr. 1086/4 Prot., datë 01.12.2020, në kuadër të procesit të rivlerësimit, duke u analizuar si burim vlerësimi në këtë raport.

3. Të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit të administruara në faqet 42-103 të dosjes së rivlerësimit. Gjatë periudhës së vlerësimit rezulton se gjyqtarja {...} ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.Referuar të dhënave statistikore për periudhën e vlerësimit, të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton se gjyqtarja {...} për periudhën 08 Tetor 2013 – 08 Tetor 2016, paraqet këtë ngarkesë çështjeve:

- **Për vitin 2013** (08.10.2013-31.12.2013), ka përfunduar 107 çështje, nga të cilat 27 civile themeli, 31 masa sigurimi, 18 kërkesa civile dhe 31 urdhëra ekzekutimi.
- **Për vitin 2014** (01.01.2014-31.12.2014), ka përfunduar 314 çështje, nga të cilat 56 civile themeli, 97 penale themeli, 103 masa sigurimi, 30 kërkesa penale, 20 kërkesa civile dhe 8 urdhëra ekzekutimi.
- **Për vitin 2015** (01.01.2015-31.12.2015), ka përfunduar 477 çështje, nga të cilat 91 civile themeli, 42 civile familjare, 49 penale themeli, 100 masa sigurimi, 4 kërkesa penale, 41 kërkesa civile, 134 urdhëra ekzekutimi.

¹Faqe 4 deri 41 e dosjes së rivlerësimit.

- ...
- **Për vitin 2016** (01.01.2016-7.10.2016), ka përfunduar 371 çështje, nga të cilat 50 civile themeli, 17 civile familjare, 1 urdhër mbrojtje, 79 penale themeli, 67 masa sigurimi, 154 kërkesa penale, 3 kërkesa civile.
- Në total në gjithë periudhën e vlerësimit ka përfunduar 1269 çështje.

4. Dosjet e përzgjedhura me short për shkak të rivlerësimit kalimtar (5 dosje), të përshkruara në mënyrë të detajuar në “Raportin për analizimin e aftësive profesionale”,² si më poshtë:

Dosja 1- Çështja penale nr. 464 regj, datë 18.01.2016 regjistrimi, që i përket të pandehurit G.N, i akuzuar për veprën penale “Vjedhje me armë në bashkëpunim dhe armëmbajtje pa leje”, përfunduar me vendimin nr. 545, datë 06.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Dosja 2- Çështja penale nr. 780/103 regj, datë 11.06.2015 regjistrimi, që i përket të pandehurve A.H dhe E.R, akuzuar për veprën penale “Dhunim banese në bashkëpunim”, e përfunduar me vendimin nr. 673, datë 27.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Dosja 3- Çështja civile nr. 1225 regj, datë 27.04.2015 regjistrimi, që i përket paditës A.K, kundër të paditurit Shoqëria “Albpetrol” sh.a, me objekt; “Shpërblim për vjetërsi në punë”, e përfunduar me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Dosja 4- Çështja civile nr. 1339 regj, datë 14.05.2015 regjistrimi, që i përket paditës Bordi i Kullimit Fier, V.N, kundër të paditurit V.D dhe Përmbartës Gjyqësor Privat N.C, me objekt; “Kundërshtim i veprimeve përmbartëse, pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, sigurimin e padisë, pezullimin e ekzekutimit”, e përfunduar me vendimin nr. 965, datë 10.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Dosja 5- Çështja penale (masë sigurimi) nr. 460, datë 30.04.2015, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt; “Vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi ndaj të dyshuarit E.Z, për veprën penale drejtim mjete në mënyrë të parregullt, e përfunduar me vendimin nr. 424, datë 02.05.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

5. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim,³ si më poshtë:

Vendimi 1- Vendimi nr. 609, datë 24.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kërkesë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, kundër të pandehurve M.H dhe E.S, akuzuar për veprat penale “Mosbindje ndaj urdhërimit të punonjësit të policisë së rendit publik, kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik dhe largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit.

Vendimi 2- Vendimi nr. 685, datë 21.05.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me paditës Shoqëria “Fybek” sh.p.k, të paditur Shoqëria “Hidro Invest” sh.p.k dhe Shoqëria “Alb Star” sh.p.k, me objekt; “Shpërblimi i dëmit të ardhur si rezultat i mospërmbushjes së detyrimit kontraktor dhe fitimin e munguar”.

Vendimi 3- Vendimi nr. 81, datë 25.01.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me paditës A.D, e paditur M.Gj, me objekt; “Pakësimin e detyrimit ushqimor për fëmijën E.D dhe heqjen e detyrimit ushqimor për fëmijën K.D, të vendosur me vendimin gjyqësor nr. 70, datë 19.01.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”.

6. Vendime të administruara për shkak të ankesave, ose kryesisht, nga organet e rivlerësimit, që i përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016. Në dosjen e dërguar nga organet e rivlerësimit, e cila

²Faqe 8-32 të Raportit, si dhe faqe 1062- 1086 të dosjes së rivlerësimit.

³Vendimet e paraqitura nga gjyqtarja së bashku me formularin e vetë vlerësimit profesional janë administruar në dosjen e rivlerësimit dhe janë përshkruar në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, faqe 4 deri 8 e Raportit, faqe 1058-1062 e dosjes së rivlerësimit.

...
përmban aktet e vlerësimit profesional të gjyqtarës, nuk rezulton të jenë administruar dosje për shkak të ankesave të publikut apo të marra kryesisht nga organet e rivlerësimit kalimtar.

7. Të dhëna nga burimet arkivore të KLD/KLGJ. Referuar Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr. 1086/4 Prot., datë 01.12.2020, rezulton se “Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013-8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur gjithësej 3 ankesa (1 në vitin 2014, 2 në vitin 2015) në Inspektoratin e KLD-së. 2 ankesat e vitit 2015, janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se ankesat zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta. Ndërsa, 1 ankesë e vitit 2014, është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe është vendosur arkivimi ankesës pasi nuk rezultuan shkelje nga ana e gjyqtarës. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë Gjyqësor ndonjë masë për procedim disiplinor”.

8. Të dhëna për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese në periudhën e vlerësimit. Referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, si dhe vërtetimit me nr. 555/1 Prot., datë 20.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 18 trajnime që i përkasin periudhës së 3 viteve të fundit, me temat përkatëse si më poshtë;

1. “Falimentimi”, më 21 tetor 2013;
2. “Juridiksioni i gjykatave shqiptare në çështjet me elementë të huaj. (Konventat dhe legjislacioni shqiptar në fushën e të drejtës kombëtare private. Kuptimi i elementëve lidhës dhe interpretimi i tyre. Konfliktet në fushën kontraktore. Konfliktet në fushën trashëgimore”, më 05-06 mars 2014;
3. “Trafikimi i brendshëm i qenieve njerëzore dhe dallimi nga veprat e tjera penale e të ngjashme me to”, më 26 maj 2014;
4. “Roli i Konventave të Hagës në çështjet e të drejtës ndërkombëtare private. (Roli i autoritetit kompetent sipas konventave dhe bashkëpunimi me gjyqësorin. Konventa për dorëzimin e akteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile e tregtare, formularët e përcaktuar nga kjo konventë”, më 12-13 qershor 2014;
5. “Veprat penale që lidhen me korrupsionin. (Parashikimet ligjore dhe aktet ndërkombëtare në këtë fushë. Praktikat më të mira nën hetimin dhe gjykimin e veprave korruptive. Korrupsioni dhe krimi i organizuar)”, më 22-23 janar 2015;
6. “Njohja dhe garantimi i së drejtës së mbrojtjes me avokat në procesin penal. (Paraqitja për njohje me fotografi. Respektimi i kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore sipas afateve të përcaktuara me ligj. Sigurimi i paraqitjes së dëshmitarëve në gjyq, si dhe të dëshmitarëve funksionarë të shtetit. Çështjet që lidhen me procedurën e gjykimin të kërkesës për sigurim prove. Njoftimi i kërkesës për gjykim të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Respektimi i afatit kohor në dispozicion të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Respektimi i afatit kohor në dispozicion të të pandehurit dhe avokatit të tij për tu njohur me provat”, më 19-20 Shkurt 2015;
7. “Mjetet e kërkimit të provës. Njohja dhe zbatimi tyre”, më 26-27 shkurt 2015;
8. “Provat e marra në kundërshtim me ligjin, papërdorshmëria. Pavlefshmëria e akteve proceduriale. (Kriteret e dallimit nga pavlefshmëria e akteve. Probleme të pavlefshmërisë së akteve, në përjasje me garancitë e mbrojtjes dhe kohëzgjatjen e procesit penal. Jurisprudenca e GJLe GJEDNJ”, më 10-11 mars 2015’

9. “Të reja që ka sjellë ligji i ri për ndryshimet dhe plotësimet e K.Penal. (Kuptimi dhe interpretimi i normave të reja të ndryshuara, sipas grup veprave, për zbatimin e drejtë dhe efektiv të tyre. Kuptimi, interpretimi dhe zbatimi i dispozitave të reja të K.Pr.Penale të ndryshuar (nëse do të jenë bërë ndryshimet e pritshme para se të miratohet program tematik i trajnimit”, më 27 mars 2015;
10. “Akuzat e reja. (Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale në gjykimin e zakonshëm dhe gjykimin e shkurtuar (nullum crimen, nullum poena sine pravia lege). Jurisprudenca e GJK dhe GJEDNJ neni 34 i Kushtetutës dhe neni 7 i KEDNJ), më 19-20 maj 2015, ka marrë pjesë në ditën e parë të trajnimit.
11. “Kontrata e sipërmarrjes në fushën e ndërtimeve. (Dallimi i saj nga kontratat e porosisë. Roli i sipërmarrjes dhe format e tij. Kalimi i pronësisë për sipërmarrjet në ndërtimin e sendeve të paluajtshme. Praktika gjyqësore lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga kontrata e sipërmarrjes”, më 11-12 qershor 2015;
12. “Problematikat e gjykimit të drejtpërdrejtë. Gjykimet e posaçme dhe gjykimet e shkurtuara”, më 23-24 qershor 2015;
13. “Instituti juridik res iudikata, kuptimi material dhe procedural, dimensionet kushtetuese, konventore dhe ligjore”, më 15 dhjetor 2015;
14. “Etika profesionale”, më 05 shkurt 2016;
15. “Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet penale”, më 16-17 shkurt 2016;
16. “Alternativat e dënimit pas reformës së sistemit të dënimeve dhe ekzekutimi i tyre. “Probleme të praktikës gjyqësore dhe përqasja me përvojën evropiane”, më 03-04 mars 2016;
17. “Mbrojtja e të dhënave personale, me fokus të veçantë mbrojtjen e të dhënave sensitive që publikohen në vendimet gjyqësore. Mbrojtja e të dhënave personale”, më 30-31 mars 2016;
18. “Procedimi disiplinor i gjyqtarëve (të dhëna bazë mbi procedurën dhe kriteret, si dhe përqasja me praktikën e mira evropiane)”, më 30 maj 2016.

9. Raport për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit {...}, me nr. 1086/4 Prot., datë 01.12.2020, faqe 1055-1093 e dosjes së rivlerësimit. Pjesa përshkruese dhe analiza e gjetjeve në këtë akt nuk përsëriten në projektraportin e vlerësimit. Për çdo element të nevojshëm të analizës dhe vlerësimit, projektraporti i vlerësimit referon drejtpërdrejt në përmbajtjen e Raportit përkatës.

10. Vendimi nr. 331, datë 11.01.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.⁴ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi ka parashtruar dhe analizuar të gjitha burimet e vlerësimit në lidhje me aftësitë profesionale të gjyqtarit, ka konkluduar lidhur me këtë kriter vlerësimi, si vijon: *“Nga hetimi i thellë administrativ i kryer, nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon figurën e gjyqtarës {...} dhe sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.* Ndërkohë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, lidhur me kriterin e pasurisë, konkludon se: *Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë dhe nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga*

⁴Vendimi nr. 331, datë 11.01.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka marrë formë të prerë për shkak të mosankimimit më datë 19.02.2021.

⋮

subjekti i rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklarimet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Subjekti ka burime të ligjshme financiare për krijimin e tyre.

Grupi II : Çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështje themeli me palë kundërshtare) si më poshtë:

Dosja 6⁵(1) – Çështja civile me nr. regjistri 1948, datë regjistrimi 23.09.2013, me palë paditëse H.T dhe të paditur Shoqëria Përmbarimore “Prestige Bailiff Services” sh.p.k, AMA, me objekt pavlefshmëri titulli ekzekutiv dhe marrja e masës së sigurimit të padisë, e përfunduar me vendimin nr. 1942, datë 26.12.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier më datë 23.09.2013, me numër regjistri 1948. Me shortin manual të datës 23.09.2013, i ka rënë për gjykim gjyqtarës {...}. Më datë 24.09.2013 (një ditë pas caktimit të çështjes me short) me vendimin “Për caktimin e seancës përgatitore”, gjyqtarja në përputhje me nenin 158/a të K.Pr.Civile, ka disponuar për caktimin e seancës përgatitore në datën 30.09.2013, ora 14:30, si dhe njoftimin e palëve. Më datë 30.09.2013, është zhvilluar seanca e parë përgatitore. Gjykata, pasi ka verifikuar paraqitjen e palëve, ku rezulton të mos jenë paraqitur palët e paditura shoqëria përmbarimore si dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive Tiranë, pasi fletëthirrja dërguar nga gjykata nuk ishte kthyer. Gjykata, ka vendosur të shtyjë seancën përgatitore për në datë 16.10.2013, ora 14.00, bazuar në nenin 175/2 të K.Pr.Civile, me qëllim njoftimin e palëve të paditura. Më datë 16.10.2013, është zhvilluar seanca e dytë përgatitore, në të cilën pas verifikimit të palëve, nga ku ka rezultuar se prezent në seancë ka qenë pala paditëse, ndërsa palët e paditura, edhe pse kanë pasur dijeni të rregullt, nuk janë paraqitur në gjykim dhe në këto kushte, gjykata ka vendosur gjykimin në mungesë të tyre. Më tej, është vijuar me dhënien e fjalës palës paditëse, për tu shprehur në lidhje me kërkesën për sigurim padie. Pala paditëse ka dhënë shpjegime, i është përgjigjur pyetjeve të gjykatës në lidhje me kërkesën si dhe ka paraqitur provat mbi të cilat bazon pretendimet e saj. Gjykata, pasi ka dëgjuar pretendimet e palës paditëse, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë. Në kushtet kur pala paditëse nuk ka pasur kërkesa të tjera, bazuar në nenet 154, 156 dhe 158/a të K.Pr.Civile, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore duke caktuar datën 31.10.2013, ora 09.30 për zhvillimin e saj.

Më datë 31.10.2013, ora 09.39, është zhvilluar seanca e parë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent në gjykim ka qenë pala paditëse, palët e paditura nuk kanë qenë prezent, edhe pse kanë pasur dijeni të rregullt për datën dhe orën e gjykimit. Pasi gjykata ka pyetur palën paditëse, bazuar në nenin 179 të K.Pr.Civile, ka vendosur vazhdimin e gjykimit në mungesë për palët e paditura. Më tej, është vijuar me të gjitha hapat proceduralë të zhvillimit të procesit në seancë gjyqësore të tilla si; është shpallur trupi gjykues, është pyetur pala paditëse nëse ka kërkesa paraprake, është deklaruar i hapur shqyrtimi gjyqësor, duke ftuar palën paditëse për të parashtruar pretendimet e saj. Pala paditëse, pasi ka parashtruar pretendimet e saj dhe provat mbi të cilat i bazon ato, i ka kërkuar kohë gjykatës për të sjellë në gjykim prova të tjera dhe gjykata, bazuar në nenin 180/5 të K.Pr.Civile, ka vendosur të pranojë kërkesën e palës paditëse për ti dhënë kohë për të sjellë në gjykim prova të tjera dhe për këtë shkak ka shtyrë seancën gjyqësore për në datë 18.11.2013, ora 13.00. Më datë 18.11.2013, ora 13.00, është zhvilluar seanca e dytë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të prezencës së palëve, është rieluar

⁵ Dosjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit, numërtohen në vijim të 6 dosjeve të përzgjedhura për procedurën e rivlerësimit kalimtar, vetëm për efekt referimi të tyre në raport.

nga gjyqtarja se pala paditëse kishte paraqitur kërkesë për shtyrje të seancës, kërkesë e cila ndodhet në dosjen gjyqësore dhe në këto kushte, ka vendosur të pranojë kërkesën e palës paditëse, duke shtyrë seancën gjyqësore për në datë 05.12.2013, ora 11.00. Më datë 05.12.2013, ora 11.00, është zhvilluar seanca e tretë gjyqësore, e cila në kushtet kur gjyqtarja për arsye shëndetësore nuk ishte paraqitur në punë, është shtyrë për në datë 06.12.2013, ora 09.00. Më datë 06.12.2013, ora 09.15, (seanca ka filluar 15 min me vonesë dhe nuk është relatuar shkaku i fillimit me vonesë) është zhvilluar seanca e katërt gjyqësore, në të cilën, pasi është verifikuar prezenca e palëve, i është dhënë fjala palës paditëse, për paraqitjen e provave për të cilat kishte kërkuar kohë. Përfaqësuesi i palës paditëse, ka deklaruar se nuk ka mundur ti paraqesë pasi nuk ka mundur të marrë praktikën e ekzekutimit të urdhrit pranë përmbauesit, duke i kërkuar gjykatës të investohet për marrjen e këtyre provave. Gjykata, ka vendosur të urdhërojë palën e paditur, shoqërinë përmbaimore, për të paraqitur në gjykim të gjithë praktikën për ekzekutimin e urdhrit dhe për këtë arsye ka vendosur të shtyrë seancën për në datë 16.12.2013, ora 14.00. Më datë 16.12.2013, ora nuk është vënë nga sekretarja gjyqësore, është zhvilluar seanca e pestë gjyqësore. Në këtë seancë, pasi është verifikuar prezenca e palëve, është relatuar nga gjykata se nga ana e përmbauesit gjyqësor është sjellë kopje e praktikës sipas urdhërimit të gjykatës, pasi pala paditëse nuk ka pasur shpjegime dhe prova të tjera, gjykata, bazuar në nenin 29 dhe 183/2 i K.Pr.Civile, ka vendosur të administrojë të gjitha provat e marra në shqyrtim duke i cituar ato, ka ftuar palën paditëse për të paraqitur prova apo fakte të tjera. Pala paditëse, ka deklaruar se nuk kishte prova apo kërkesa të tjera dhe ka kërkuar ti jepet fund hetimit gjyqësor. Gjykata, bazuar në nenin 302 e K.Pr.Civile, ka ftuar palën paditëse për të paraqitur pretendimet përfundimtare. Pala paditëse ka kërkuar kohë për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare dhe gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën, duke i dhënë kohë palës paditëse për të paraqitur pretendimet përfundimtare për në datë 23.12.2013, ora 12.45. Më datë 23.12.2013, ora 12.45, është zhvilluar seanca e gjashtë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, i është dhënë fjala palës paditëse për të paraqitur konkluzionet dhe pas parashtrimit të konkluzioneve nga përfaqësuesi i palës paditëse, gjykata, ka vendosur të shtyrë shpalljen e vendimit për në datë 26.12.2013, ora 11.30. Më datë 26.12.2013, ora 11.30, është zhvilluar seanca e shtatë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, gjykata e tërhequr për vendim, ka shpallur vendimin.

Vendimi përfundimtar me nr. 1942, datë 26.12.2013, është i organizuar në tre pjesët përbërëse: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi, vendimi përmban elementët e domosdoshëm, sipas parashikimeve të nenit 310 të K.Pr.Civile. Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues dhe sekretaren gjyqësore, kohën dhe vendin e zhvillimit të gjykimit, identitetin e palëve, si dhe përfaqësuesit tyre, objektin dhe bazën ligjore të padisë, kërkimet përfundimtare të palës paditëse, në mënyrë të përmbledhur, në një fjali të vetme si dhe faktin se gjykimi është zhvilluar në mungesë të palëve të paditura). Pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimit organizohet në një strukturë unike, duke u ndarë në paragrafë. Në fillim të arsyetimit të vendimit gjyqtarja parashtron në një fjali, juridiksionin dhe kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës. Më tej, gjyqtarja përshkruan rrethanat e faktit të provuara në gjykim, duke i integruar ato me provat shkresore si dhe pretendimet palës paditëse në lidhje me to, duke vijuar arsyetimin në lidhje me bazueshmërinë ose jo të tyre. Në këtë pjesë të arsyetimit, gjyqtarja, rimer në analizë faktet dhe provat si dhe pretendimet e palës paditëse, duke arritur në konkluzionet lidhur me faktet e provuara duke i shoqëruar ato me citimin dhe analizën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Gjyqtarja, arsyeton duke arritur në konkluzionin se të drejtat e pretenduara

nga pala paditëse, nuk mund të rivendosen nëpërmjet padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv të parashikuar nga neni 609 i K.Civil, por me anë të padisë të kundërshtimit të veprimeve përmbartimore, parashikuar nga neni 410 i K.Pr.Civile. Më pas, gjykata, interpreton dispozitat ligjore në lidhje me pavlefshmërinë e titullit dhe kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, duke nxjerrë në pah ndryshimet midis këtyre dispozitave dhe duke orientuar palën paditëse, që në zgjidhjen në themel të pretendimeve të saj, duhet ti drejtohet gjykatës me padi për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, bazuar në nenin 610 të K.Pr.Civile. Me tej, gjykata citon dhe arsyeton vendimin e marrë prej saj në seancë përgatitore në lidhje me kërkesën e palës paditëse për sigurimin e padisë. Në përfundim, gjykata arrin në konkluzionin se padia është e pabazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet rrëzuar. Në pjesën urdhëruese të vendimit referohet baza ligjore procedurale e vendimmarrjes (nenet 126, 306, 308, 609 e vijues të K.Pr.Civile), si dhe disponimin e gjykatës për rrëzimin e padisë, disponimi për shpenzimet gjyqësore, si dhe e drejta e ankimit, afatin dhe gjykatën kompetente për ushtrimin e së drejtës së ankimit.

Nga pikëpamja formale, vendimi ; përmban 7 faqe, ka një strukturë të qëndrueshme, janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, fjalitë paraqiten me gjatësi mesatare dhe të kuptueshme. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar nga gjyqtarja në kryesekretarinë e gjykatës në datën 06.01.2014, pas 10 ditëve nga shpallja, brenda afatit të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile. Gjykimi i çështjes nga gjyqtarja është realizuar për 3 muaj e 3 ditë, në intervalin kohor 23.09.2013 – 26.12.2013. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm (jo më tej se 6 muaj) të përcaktuar në Vendimin të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 9 seanca, 2 seancë përgatitore 1 prej të cilave ka qenë jo produktive për shkak të mospasjes dijeni të rregullt për seancën të palëve të paditura dhe 7 seanca gjyqësore, prej të cilave 2 kanë qenë jo produktive, për shkak të kërkesës për shtyrje të paraqitur nga pala paditëse si dhe të mungesës për arsye shëndetësore të gjyqtarës.
- Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 3 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm (jo më tej se 6 muaj), sipas Vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtarja. Seancat gjyqësore janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve ligjore.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat proceduralë të zhvillimit të gjykimit civil të themelit. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse, si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt dhe gjyqtarja rezulton që të jetë shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse.

- Vendimi i arsytuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar, sipas një strukture të qartë dhe të organizuar në mënyrë logjike. Pjesa arsytuese e vendimit është e strukturuar duke analizuar pretendimet e palës paditëse, në referim të dispozitave procedurale dhe materiale.

Dosja 7 (2) - Çështja civile me nr. regjistri 984, datë regjistrimi 11.03.2015, me palë paditëse I.Th, të paditur Shoqëria “Albpetrol” sh.a, objekti; “Dëmshpërblim page”. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. 615, datë 11.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier më datë 11.03.2015, me numër regjistri 984. Me shortin elektronik të datës 12.03.2015, i ka rënë për gjykim gjyqtarës {...}. Më datë 13.03.2015(*një ditë pas caktimit të çështjes me short*) me vendimin “Për caktimin e seancës përgatitore”, gjyqtarja në përputhje me nenin 158/a të K.Pr.Civile, ka disponuar për caktimin e seancës përgatitore në datën 02.04.2015, ora 09.00, si dhe njoftimin e palëve. Më datë 02.04.2015, është zhvilluar seanca e parë përgatitore. Gjykata, pasi ka verifikuar paraqitjen e palëve, ku prezent në seancë ka qenë paditësi me përfaqësuesin e tij të legjitimuar nga gjykata, pala e paditur nëpërmjet përfaqësuesit me autorizim. Në këtë seancë, pasi i është dhënë fjala palës paditëse për të dhënë shpjegime dhe palës së paditur për të paraqitur prapësimet, gjykata, ka vlerësuar se padia është e plotë dhe ka vendosur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore, duke caktuar datën 21.04.2015, ora 09.30, për zhvillimin e saj.

Më datë 21.04.2015, ora 09.42, është zhvilluar seanca e parë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent në gjykim ka qenë pala paditëse, pala e paditur nuk kanë qenë prezent, edhe pse kanë pasur dijeni të rregullt për datën dhe orën e gjykimit. Pasi gjykata ka pyetur palën paditëse, bazuar në nenin 179 të K.Pr.Civile, ka vendosur vazhdimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur. Më tej është vijuar me të gjitha hapat proceduralë të zhvillimit të procesit në seancë gjyqësore të tilla si; është shpallur trupi gjykues, është pyetur pala paditëse nëse ka kërkesa paraprake, është deklaruar i hapur shqyrtimi gjyqësor, duke ftuar palën paditëse për të parashtruar pretendimet e saj. Pala paditëse, pasi ka parashtruar pretendimet e saj dhe provat mbi të cilat i bazon ato, i ka kërkuar kohë gjykatës për të sjellë në gjykim në formën e kërkuar nga ligji provën vërtetim page të paditësit, dhe gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e palës paditëse, për ti dhënë kohë për të paraqitur në gjykim provën në formën e kërkuar nga ligji dhe për këtë shkak ka vendosur të shtyjë seancën gjyqësore për në datë 07.05.2015, ora 09.00. Më datë 07.05.2015, ora 09.18, (seanca ka filluar 18 min me vonesë dhe nuk është relatuar shkak i fillimit me vonesë) është zhvilluar seanca e dytë gjyqësore, në të cilën, pasi është verifikuar prezenca e palëve, ku prezent në seancë ka qenë pala paditëse dhe pala e paditur nëpërmjet përfaqësueses me autorizim. Gjykata, pasi ka revokuar vendimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur, të marrë në seancën e parë gjyqësore, i ka dhënë fjalën palës paditëse për paraqitjen e provës për të cilën kishte kërkuar kohë seancën e kaluar. Pasi pala paditëse ka paraqitur provën, i është dhënë fjala palës së paditur për të paraqitur prapësimet dhe provat mbi të cilat i bazon ato. Pala paditëse, ka paraqitur para gjykatës prapësimet dhe provat. Gjykata, pasi ka lejuar të marrë në shqyrtim dhe më pas të administrojë provat e paraqitura nga palët, konform nenit 302 të K.Pr.Civile, kaftuar palët për të paraqitur diskutimin përfundimtar. Pala paditëse ka kërkuar kohë për paraqitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim. Gjykata, ka vendosur të pranojë kërkesën e palës paditëse për ti dhënë kohë për paraqitjen e diskutimit përfundimtar me shkrim dhe për këtë shkak, ka shtyrë seancën gjyqësore për në datë 11.05.2015, ora 11.30. Më datë 11.05.2015, ora 11.53 (seanca ka filluar 23 min me vonesë dhe nuk është relatuar shkak

⋮
i fillimit me vonejë) është zhvilluar seanca e tretë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, i është dhënë fjala palës paditëse dhe më pas palës së paditur për të paraqitur diskutimin përfundimtar dhe gjykata, pasi është tërhequr për vendim, në kthim ka shpallur vendimin përfundimtar, duke vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Vendimi përfundimtar me nr. 615, datë 11.05.2015, është i organizuar në tre pjesët përbërëse: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi, vendimi përmban elementët e domosdoshëm, sipas parashikimeve të nenit 310 të K.Pr.Civile. *Pjesa hyrëse* e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues dhe sekretaren gjyqësore, kohën dhe vendin e zhvillimit të gjykimit, identitetin e palëve, si dhe përfaqësuesit tyre, objektin dhe bazën ligjore të padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, (në mënyrë të përmbledhur, në një fjali të vetme). *Pjesa përshkruese-arsyetuese* e vendimit organizohet në një strukturë unike, duke u ndarë në nënpjesë. Në fillim të arsyetimit, në nënpjesën të titulluar “Vëren”, gjyqtarja parashtron ndryshimin e objektit të padisë, të kërkuar nga pala paditëse dhe të pranuar nga gjykata, bazuar në nenin 185 të K.Pr.Civile. Më tej, në nënpjesën e titulluar “Faktet e çështjes”, gjyqtarja përshkruan rrethanat e faktit të provuara në gjykim duke i integruar ato me provat shkresore të administruara gjatë gjykimit. Në vijim, gjyqtarja, në nënpjesën e titulluar “Pretendimet dhe prapësimet e palëve”, parashtron pretendimet e palës paditëse dhe më pas prapësimet e palës së paditur, duke vazhduar arsyetimin me nëndarjen e titulluar “Vlerësimi i Gjykatës”, në të cilin gjyqtarja rimer në analizë faktet, provat, pretendimet dhe prapësimet e palëve, duke i shoqëruar me citimin dhe analizën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Gjyqtarja, arsyeton në lidhje me shpërblimin për vjetërsi, duke cituar dhe analizuar plotësimin e kushteve të parashikuara nga neni 145/1 i Kodit të Punës, duke i ndërthurur me provat e rezultuara në gjykim, duke trajtuar të drejtën e shpërblimit për vjetërsi në punë si dhe rastet përjashtimore kur ligjvënësi ka parashikuar humbjen e kësaj të drejte. Më pas, gjyqtarja trajton dhe analizon pretendimet e tjera të paditësit, në lidhje me dëmshpërblimin për mosrespektim të afateve të njoftimit, duke cituar dhe analizuar nenin 143 të Kodit të Punës, në raport me pretendimet, prapësimet dhe provat e rezultuara në gjykim. Në përfundim të arsyetimit, gjyqtarja ndalet në pretendimin e palës paditëse në lidhje me shpenzimet gjyqësore, duke cituar dhe analizuar nenin 102 të K.Pr.Civile. Gjyqtarja, në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi ka analizuar rrethanat e faktit, vlerësuar provat e marra në shqyrtim, pretendimet dhe prapësimet e palëve, ka arritur në konkluzionin që kërkesë padia duhet pranuar pjesërisht si e bazuar në ligj dhe prova. *Në pjesën urdhëruese* të vendimit referohet baza ligjore procedurale e vendimarrjes (nenet 126, 302, 310 të K.Pr.Civile si dhe nenin 145 të Kodit të Punës), si dhe disponimin e gjykatës për pranimin pjesërisht të padisë, disponimi për shpenzimet gjyqësore, si dhe e drejta e ankimit, afatin dhe gjykatën kompetente për ushtrimin e së drejtës së ankimit.

Nga pikëpamja formale, vendimi ; përmban 10 faqe, ka një strukturë të qëndrueshme, janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, fjalitë paraqiten me gjatësi mesatare dhe të kuptueshme. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar nga gjyqtarja në kryesekretarinë e gjykatës në datën 21.05.2015, pas 10 ditëve nga shpallja, brenda afatit të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile. Gjykimi i çështjes nga gjyqtarja është realizuar për 1 muaj e 29 ditë, në intervalin kohor 12.03.2015 – 11.05.2015. Kohëzgjatja e

grykimit është brenda standardit minimal kohor për grykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm (jo më tej se 6 muaj) të përcaktuar në Vendimin të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 4 seanca, 1 seancë përgatitore e cila ka qenë produktive dhe 3 seanca gjyqësore të cilat kanë qenë produktive.
- Grykimi ka zgjatur 1 muaj e 29 ditë, brenda standardit minimal kohor për grykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm (jo më tej se 6 muaj), sipas Vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtarja. Seancat gjyqësore janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve ligjore.
- Grykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat proceduralë të zhvillimit të grykimit civil të themelit. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse, si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt dhe gjyqtarja rezulton që të jetë shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar, sipas një strukture të qartë dhe të organizuar në mënyrë logjike. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar duke analizuar pretendimet e palëve, në referim të dispozitave procedurale dhe materiale.

Dosja 8 (3) - Çështja penale me nr. regjistri 532, datë regjistrimi 22.05.2014, me të dëmtuar akuzuese T.D, kundër të të akuzuarës R.D, akuzuar për veprën penale të “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 59 e vijim të K.Pr.Penale, e përfunduar me vendimin nr. 193, datë 26.03.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 22.05.2014, me numër regjistri 532. Me shortin elektronik të datës 22.05.2014, i ka rënë për grykim gjyqtares {...}. Me vendimin e datës 23.05.2014, (1 ditë pas caktimit të çështjes me short), duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 338 të K.Pr.Penale, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtarja, duke caktuar seancën e pajtimit më datë 10.06.2014, ora 10.00, dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve. Më datë 10.06.2014, orë s’ka, është zhvilluar seanca e parë e pajtimit, në të cilën pas verifikimit të paraqitjes së palëve, gjykata, bazuar në nenin 342/1/3 i K.Pr.Penale, në kushtet e mospasjes dijeni për seancën të të dëmtuarës akuzuese, ka vendosur të shtyjë seancën me qëllim njoftimin e saj për në datë 24.06.2014, ora 10.00. Më datë 24.06.2014, orë s’ka, është zhvilluar seanca e dytë e pajtimit, në të cilën, pas verifikimit të palëve, ku prezent në seancë ka qenë e dëmtuara akuzuese dhe e akuzuara, pasi i është dhënë fjala të dëmtuarës akuzuese për të

dhënë shpjegime, si dhe provat ku i mbështet, më pas i është dhënë fjala të akuzuarës e cila ka dhënë shpjegime. Gjykata, në kushtet kur midis palëve nuk ka patur mundësi pajtimi, ka vendosur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore duke caktuar datën 08.07.2014, ora 10.00 për zhvillimin e saj.

Më datë 08.07.2014, orë s'ka, është zhvilluar seanca e parë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të prezencës së palëve, ku prezent ka qenë e dëmtuara akuzuese dhe e akuzuara, nuk është paraqitur personi i tretë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier. Nga verifikimi i shkaqeve të mosprezencës, ka rezultuar se personi i tretë, edhe pse ka pasur dijeni për datën dhe orën e gjykimit, nuk është paraqitur në gjykim. Gjykata, duke e konsideruar të domosdoshme prezencën në seancë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, ka vendosur të shtyjë seancën për në datë 22.07.2014, ora 10.00. Më datë 22.07.2014, orë s'ka, është zhvilluar seanca e dytë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent ka qenë e dëmtuara akuzuese dhe përfaqësuesi i zgjedhur prej saj, nuk ka qenë prezent e akuzuara por përfaqësuesi i zgjedhur prej saj, në prezencë të personit të tretë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier. Pasi nga ana e gjykatës i janë shpjeguar të dëmtuarës të drejtat dhe detyrimet procedurale, është shpallur trupi gjykues, janë pyetur palët nëse kanë kërkesa paraprake, është deklaruar i hapur shqyrtimi gjyqësor, duke i dhënë fjalën palës së dëmtuar për të parashtruar faktet dhe provat ku i mbështet ato. Përfaqësuesi i zgjedhur nga e dëmtuara ka parashtruar faktet dhe provat mbi të cilat i bazon. I është dhënë fjala mbrojtësittë zgjedhur nga e akuzuara, i cili ka paraqitur pretendimet, ka kërkuar kohë për të paraqitur prova dhe thirrjen e dëshmitarëve. Mbrojtësi i të dëmtuarës ka kërkuar thirrjen në gjykim të dëshmitarëve. Gjykata, ka vendosur të pranojë kërkesat për të paraqitur prova dhe me qëllim thirrjen në gjykim të dëshmitarëve, ka shtyrë seancën gjyqësore për në datë 05.09.2014, ora 12.00. Më datë 05.09.2014, ora 12.11, është zhvilluar seanca e tretë gjyqësore, në të cilën pasi është verifikuar prezenca e palëve, është konstatuar se nuk ka qenë prezent avokati i zgjedhur prej të akuzuarës, i cili kishte paraqitur para gjykatës një kërkesë për shtyrje, gjithashtu, nuk ka qenë prezent dhe prokurori. Gjykata, bazuar në nenin 342/2/3 të K.Pr.Penale, ka vendosur të ndërpresë seancën për shkak të mosparaqitjes së prokurorit dhe të përfaqësuesit të zgjedhur nga e akuzuara, dhe ta shtyjë atë për në datë 22.09.2014, ora 10.00. Më datë 22.09.2014, ora 10.00, është zhvilluar seanca e katërt gjyqësore, e cila është shtyrë për në datë 03.10.2014, ora 09.00, pasi gjyqtarja për arsye shëndetësore nuk është paraqitur në punë. Më datë 03.10.2014, ora 09.11, është zhvilluar seanca e pestë gjyqësore, e cila pas verifikimit të palëve, ka rezultuar se prokurori, nuk ka qenë prezent pasi ndodhej në një gjykim tjetër dhe për këtë shkak, gjykata ka shtyrë seancën për në datë 16.10.2014, ora 15.00. Më datë 16.10.2014, ora 15.00, është zhvilluar seanca e gjashtë gjyqësore, e cila është shtyrë për në datë 31.10.2014, ora 13.00, pasi gjyqtarja për arsye shëndetësore nuk është paraqitur në punë. Më datë 31.10.2014, ora 13.00, është zhvilluar seanca e shtatë gjyqësore, e cila është shtyrë për në datë 17.11.2014, ora 13.00, pasi gjyqtarja ndodhej në një konferencë gjyqësore në Maltë. Më datë 17.11.2014, orë s'ka, është zhvilluar seanca e tetë gjyqësore. Në këtë seancë, pasi është verifikuar prezenca e palëve dhe e dëshmitarëve të thirrur në gjykim dhe pasi janë pyetur dy dëshmitarët, gjykata, bazuar në nenin 151 dhe 357/1 të K.Pr.Penale, ka vendosur të pranojë kërkesën e mbrojtësit të të akuzuarës për të thirrur në cilësinë e dëshmitarit shtetasin D.H si dhe për ti dhënë kohën e nevojshme për të paraqitur në formën e kërkuar nga ligji akt dëshmi mjeko ligjore të të akuzuarës, duke shtyrë seancën gjyqësore për në datë 02.12.2014, ora 12.30. Më datë 02.12.2014, ora 12.30, është zhvilluar seanca e nëntë gjyqësore, e cila është shtyrë me qëllim njoftimin e mbrojtësit të të dëmtuarës akuzuese, pasi nuk ishte paraqitur në gjykim, duke caktuar datën 12.12.2014, ora 10.00, për zhvillimin e seancës së ardhshme gjyqësore. Më datë 12.12.2014, ora 10.05, është zhvilluar seanca e dhjetë gjyqësore, e cila përsëri është shtyrë për shkak të mungesës së

mbrojtësit të të dëmtuarës akuzuese, e cila ka kërkuar të shtyhet seanca me qëllim që të jetë prezent mbrojtësi i saj. Gjykata, ka vendosur të pranojë kërkesën e të dëmtuarës akuzuese duke shtyrë seancën gjyqësore për në datë 23.12.2014, ora 09.30. Më datë 23.12.2014, ora 09.52 (seanca gjyqësore ka filluar 22 min me vonesë dhe nuk është relatuar shkaku i fillimit me vonesë) është zhvilluar seanca e njëmbëdhjetë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve dhe paraqitjes së dëshmitarit, pasi gjykata ka paralajmëruar dëshmitarin në lidhje me përgjegjësitë ligjore në rast dëshmie të rreme ose refuzimi për të dëshmuar, është vijuar me pyetjen e dëshmitarit. Pas pyetjes së dëshmitarit, mbrojtësi i të akuzuarës, ka kërkuar kohë për të paraqitur prova të reja të cilat nuk ka mundur ti paraqesë deri në këtë moment. Gjykata, ka vendosur të shtyjë seancën gjyqësore për tu shprehur në lidhje me këtë kërkesë, duke qenë se e ka pasur të pamundur objektivist për tu shprehur në lidhje me të, për shkak të gjykimeve të tjera, duke shtyrë seancën gjyqësore për në datë 13.01.2015, ora 14.30. Më datë 13.01.2015, ora 15.12 (seanca ka filluar 42 min me vonesë dhe nuk është relatuar shkaku i fillimit me vonesë) është zhvilluar seanca e dymbëdhjetë gjyqësore. Kjo seancë është shtyrë pasi mbrojtësi i të dëmtuarës nuk është paraqitur në gjykim për shkaqe të përligjura, duke caktuar datën 28.01.2015, ora 12.30, për zhvillimin e seancës së ardhshme gjyqësore. Më datë 28.01.2015, ora 12.39, është zhvilluar seanca e trembëdhjetë gjyqësore, e cila përsëri është shtyrë për shkak të mungesës së mbrojtësit të të akuzuarës, e cila ka kërkuar që mbrojtësi të jetë prezent në gjykim, duke caktuar datën 06.02.2015, ora 12.00, për zhvillimin e seancës së ardhshme gjyqësore. Më datë 06.02.2015, ora 12.00, është zhvilluar seanca e trembëdhjetë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, gjykata është shprehur në lidhje me kërkesën e mbrojtësit të të akuzuarës për të paraqitur prova të reja në gjykim, duke vendosur rrëzimin e kërkesës si dhe konform nenit 371 të K.Pr.Penale, ka urdhëruar bashkëngjitjen e akteve me procesverbalin në fashikullin e gjykimit, si dhe ka ftuar palët për diskutim përfundimtar. Mbrojtësi i të dëmtuarës akuzuese ka kërkuar kohë për të paraqitur konkluzionet përfundimtare dhe gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën e tij duke shtyrë seancën për në datë 13.02.2015, ora 12.00. Më datë 13.02.2015, ora 12.05, është zhvilluar seanca e katëmbëdhjetë gjyqësore, e cila pas verifikimit të palëve dhe paraqitjes së konkluzioneve nga mbrojtësi i të dëmtuarës akuzuese, në kushtet kur mbrojtësi i të akuzuarës ka kërkuar kohë për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, seanca është shtyrë për në datë 02.03.2015, ora 09.00 (gjyqtarja ka relatuar dhe shkaku të lënies së seancës tej afatit ligjor). Më datë 02.03.2015, ora 09.11, është zhvilluar seanca e pesëmbëdhjetë gjyqësore, e cila pas verifikimit të palëve dhe paraqitjes së konkluzioneve nga mbrojtësi i të akuzuarës, në kushtet kur prokurori ka kërkuar kohë për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, seanca është shtyrë për në datë 13.03.2015, ora 11.00. Më datë 13.03.2015, ora 11.00, është zhvilluar seanca e gjashtëmbëdhjetë gjyqësore, e cila pas verifikimit të palëve, në kushtet kur prokurori ka kërkuar përsëri kohë për paraqitjen e diskutimeve përfundimtare me shkrim pasi nuk kishte mundur ti përgatisë ato për shkak të ngarkesës në punë, seanca është shtyrë për në datë 26.03.2015, ora 13.30. Më datë 26.03.2015, ora 13.49 (seanca ka filluar 19 min me vonesë dhe është relatuar shkaku i fillimit me vonesë), është zhvilluar seanca e shtatëmbëdhjetë gjyqësore. Në këtë seancë, pasi parashtimit të konkluzioneve nga ana e prokurorit, deklarimit të mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, gjykata është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur vendimin.

Vendimi përfundimtar me nr. 193, datë 26.03.2015, është i organizuar në tre pjesët përbërëse: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi, vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.Penale. *Pjesa hyrëse* e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues,

identitetin e palëve, akuzën, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve të përmbledhura në një fjali. *Pjesa përshkruëse-arsyetuese* e vendimit organizohet në një strukturë unike, duke u ndarë në nënpjesë. Në fillim të arsyetimit, në nënpjesën të titulluar “Vëren”, gjyqtarja, parashtron faktin se pas paraqitjes së kërkesës për gjykim të të dëmtuarës akuzuese dhe pas përpjekjeve nga gjykata për pajtim, konform nenit 338 të K.Pr.Penale, ka vijuar me shqyrtimin gjyqësor të çështjes me pjesëmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, në respektim të kërkesave të nenit 59/2 të K.Pr.Penale. Më pas, vijohet me përshkrimin e përmbledhur të ngjarjes e cila përbën faktin penal objekt akuze dhe më pas me renditjen e provave mbi të cilat mbështetet fakti i provuar në gjykim. Më pas, gjykata vijon arsyetimin, duke trajtuar faktin se e akuzuara, nga provat e rezultuara në gjykim, nuk ka vepruar në kufijtë e mbrojtjes së nevojshme, në kuptim të nenit 19 të K.Penal. Gjithashtu, gjykata ka trajtuar elementët e veprës penale, subjektin, anën subjektive, duke arritur në konkluzionin, sipas analizës dhe vlerësimit të provave të marra në gjykim, se e akuzuara ka konsumuar plotësisht elementët të e figurës së veprës penale dhe si rrjedhojë duke e deklaruar atë fajtorë. Më tej, gjykata, vijon me arsyetimin, duke parashtruar shkaqet të cilat ka arritur në këtë konkluzion, duke marrë në konsideratë dhe përfaqësuesin e organit të akuzës, i cili kishte kërkuar deklarinë fajtor të të akuzuarës si dhe duke trajtuar rrezikshmërinë e veprës penale të konsumuar nga e akuzuara. Në fund të arsyetimit, gjykata shprehet në lidhje me llojin dhe masën e dëmit, duke pasur parasysh jo vetëm shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale konkrete, por dhe shkallën e fajit, ku në ardhjen e pasojave, ka ndikuar dhe vetë sjellja e të dëmtuarës akuzuese. Gjithashtu, gjykata, ka parashtruar rrethanën e cila ka ndikuar në zbutjen e dënimit, duke pasur parasysh gjendjen e vështirë ekonomike dhe familjare të të akuzuarës. *Pjesa e dispozitivit të vendimit* është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes (nenet 379, 384, 390, e 485 të K.Pr.Penale, nenet 34, 47, 49, 90/1 të K.Penal), disponimet mbi deklarinë fajtor të të akuzuarës, duke përmendur nenin përkatës, masën e dënimit me gjobë, afatin e shlyerjes së gjobës, disponimin për shpenzimet gjyqësore, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankimi, si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

Nga pikëpamja formale, vendimi ; përmban 5 faqe, ka një strukturë të qëndrueshme, janë respektuar rregullat e drejtshkkrimit, përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, fjalitë paraqiten me gjatësi mesatare dhe të kuptueshme. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar nga gjyqtarja në kryesekretarinë e gjykatës në datën 31.03.2015, pas 5 ditëve nga shpallja, brenda afatit për të ushtuar ankimi. Gjykimi i çështjes nga gjyqtarja është realizuar për 10 muaj e 4 ditë, në intervalin kohor 22.05.2014 – 26.03.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është në tejkallim të standardit minimal kohor për gjykimet penale në shkallë të parë kur procedohet për kundërvajtje (jo më tej se 4 muaj), të përcaktuar në Vendimin të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 19 seanca, prej të cilave 2 seanca pajtimi, ku 1 seancë ka qenë jo produktive pasi është shtyrë me qëllim njoftimin e palëve dhe 17 seanca gjyqësore, nga të cilat 10 seanca kanë qenë jo produktive pasi janë shtyrë për shkaqe si; mungesa e prokurorit në gjykim, mungesa e mbrojtësit të të dëmtuarës akuzuese apo e mbrojtësit të të akuzuarës, mungesa për arsye shëndetësore apo pjesëmarrja një konferencë e gjyqtarës.

- Gjykimi ka zgatur 10 muaj e 4 ditë, në tejkalim të standardit minimal kohor për gjykimet penale në shkallë të parë kur procedohet për kundërvajtje (jo më tej se 4 muaj).
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtarja edhe pse kohëzgjatja e gjykimit ka qenë në tejkalim të standardit minimal kohor, për shkaqe të pavarura nga gjyqtarja. Seancat gjyqësore janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 342, pika 2, të K.Pr.Penale.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat proceduralë të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet ligjore procedurale për gjykimin e zakonshëm. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse, si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit, sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.Penale, sipas një strukture standarde që ndjek gjyqtarja, të qartë dhe organizuar në mënyrë logjike.

Dosja 9 (4) - Çështja civile me nr. regjistri 479, datë regjistrimi 03.11.2015, me palë paditëse A.A, të paditur Kompania “Simmons Edeco Limited”, objekti; “Dëmshpërblim page”. Çështja ka përfunduar me vendimin nr. 95, datë 28.01.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier më datë 03.11.2015, me numër regjistri 479. Me shortin elektronik të datës 03.11.2015, i ka rënë për gjykim gjyqtarës {...}. Më datë 03.11.2015 (në të njëjtën ditë të caktimit të çështjes me short) me vendimin “Për caktimin e seancës përgatitore”, gjyqtarja në përputhje me nenin 158/a të K.Pr.Civile, ka disponuar për caktimin e seancës përgatitore në datën 25.11.2015, ora 11.30, si dhe njoftimin e palëve. Më datë 25.11.2015, është zhvilluar seanca e parë përgatitore. Gjykata, pasi ka verifikuar paraqitjen e palëve, ku prezent në seancë ka qenë pala paditëse, nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë, si dhe pala e paditur nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë të përgjithshme. Në këtë seancë, pasi i është dhënë fjala palës paditëse për të dhënë shpjegime dhe palës së paditur për të paraqitur prapësimet, gjykata, ka vlerësuar se padia është e plotë dhe ka vendosur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore, duke caktuar datën 18.12.2015, ora 09.30, për zhvillimin e saj.

Më datë 18.12.2015, ora 09.31 është zhvilluar seanca e parë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent në gjykim ka qenë pala paditëse dhe pala e paditur nëpërmjet përfaqësuesve të tyre me prokurë, është vijuar me të gjitha hapat proceduralë të zhvillimit të procesit në seancë gjyqësore të tilla si; është shpallur trupi gjykues, janë pyetur palët nëse kanë kërkesa paraprake, është deklaruar i hapur shqyrtimi gjyqësor, duke ftuar palën paditëse për të parashtruar pretendimet e saj. Pala e paditur, pas parashtrimeve të palës paditëse dhe provave mbi të cilat i bazon ato, ka kërkuar kohë për tu njohur me parashtrimet dhe provat e paraqitura nga pala paditëse. Gjykata, bazuar në nenin 171/a dhe 156 të K.Pr.Civile, ka pranuar kërkesën e përfaqësuesit të palës së paditur dhe për këtë shkak ka shtyrë seancën gjyqësore për në datë 13.01.2016, ora 09.30. Më datë 13.01.2016, ora 09.30, është zhvilluar seanca e dytë gjyqësore, e cila pas verifikimit të palëve, ku prezent ka qenë pala paditëse nëpërmjet përfaqësuesit të saj dhe përfaqësuesi i palës së paditur ka paraqitur para gjykatës kërkesë për shtyrje të seancës për shkak se ndodhej në një gjykim tjetër. Gjykata, duke e konsideruar për shkaqe të përligjura këtë kërkesë, ka vendosur të shtyjë seancën për në datë 21.01.2016, ora 11.30. Më datë 21.01.2016, ora 11.55 (seanca ka filluar 25 min me vonesë dhe nuk është relatuar shkaku i fillimit me

•
•
•
vonesë), është zhvilluar seanca e tretë gjyqësore. Në këtë seancë, pasi është verifikuar prezenca e palëve, ku prezant në seancë ka qenë pala paditëse dhe pala e paditur nëpërmjet përfaqësuesve me prokurë, i është dhënë fjala palës së paditur për të paraqitur prapësimet si dhe provat, ka vendosur të marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga palët, dhe në kushtet kur palët nuk kanë pasur prova apo kërkesa të tjera, ka vendosur të administrojë të gjitha provat e paraqitura nga palët, duke mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe duke ftuar palët për të paraqitur konkluzionet përfundimtare. Në kushtet kur palët kanë kërkuar kohë për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, gjykata ka vendosur të pranojë këtë kërkesë duke shtyrë seancën gjyqësore për në datë 25.01.2016, ora 09.30. Më datë 25.01.2016, ora 09.48 (seanca ka filluar 19 min me vonesë dhe nuk është relatuar shkaku i fillimit me vonesë), është zhvilluar seanca e katërt gjyqësore, në të cilën pas verifikimit të palëve, paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare nga pala paditëse dhe më pas nga pala e paditur, gjykata, duke e konsideruar çështjen komplekse, ka vendosur të shtyjë shpalljen e arsytuar të vendimit për në datë 28.01.2016, ora 14.30. Më datë 28.01.2016, ora 14.35, është zhvilluar seanca e pestë gjyqësore, në të cilën pas verifikimit të palëve, ku ka rezultuar se pala paditëse dhe pala e paditur nuk kanë qenë prezent, gjyqtarja, pas tërheqjes në dhomë këshillimi, ka shpallur vendimin, duke vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.

Vendimi përfundimtar me nr. 95, datë 28.01.2016, është i organizuar në tre pjesët përbërëse: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi, vendimi përmban elementët e domosdoshëm, sipas parashikimeve të nenit 310 të K.Pr.Civile. *Pjesa hyrëse* e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues dhe sekretaren gjyqësore, kohën dhe vendin e zhvillimit të gjykimit, identitetin e palëve, si dhe përfaqësuesit tyre, objektin dhe bazën ligjore të padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, (në mënyrë të përmbledhur, në një fjali të vetme). *Pjesa përshkruese-arsyetuese* e vendimit organizohet në një strukturë unike, duke u ndarë në nënpjesë. Në fillim të arsytimit, në nënpjesën të titulluar “Vëren”, gjyqtarja parashtron paraqitjen e padisë nga ana e palës paditëse, si dhe përshkruan rrethanat e faktit që rezultuan të provuara në gjykim. Në vijim, gjyqtarja në vendim paraqet pretendimet në mënyrë të përmbledhur të palës paditëse si dhe prapësimet e palës së paditur. Më tej, gjyqtarja citon të gjitha dispozitat ligjore të marra në konsideratë prej saj në arsytimin e vendimit, duke vazhduar me nëndarjen e titulluar “Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me pretendimet e palës paditëse”, në të cilin gjyqtarja merr në analizë faktet, provat, pretendimet e palës paditëse, duke i shoqëruar me citimin dhe analizën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në çështjen konkrete. Gjyqtarja, trajton dhe analizon të gjitha pretendimet e palës paditëse, në lidhje me dëmshpërblimin për një vit pagë, si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar si dhe dëmshpërblimit prej 3 muaj page, për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit, dëmshpërblimit për mosrespektim të procedurës si dhe shpërblimit për vjetërsi në punë, duke i integruar me provat e rezultuara të provuara në gjykim dhe me interpretim të dispozitave ligjore që gjejnë zbatim për secilin rast. Në përfundim, gjyqtarja shprehet dhe në lidhje me shpenzimet gjyqësore, duke ia ngarkuar palës paditëse, në rrethanat kur padia është rrëzuar. Në pjesën urdhëruese të vendimit referohet baza ligjore procedurale e vendimmarrjes (nenet 106, 126, 306, 310, 443, 444 të K.Pr.Civile), si dhe disponimin e gjykatës për rrëzimin e kërkesë padisë, disponimi për shpenzimet gjyqësore, si dhe e drejta e ankimit, afatin dhe gjykatën kompetente për ushtrimin e së drejtës së ankimit.

⋮

Nga pikëpamja formale, vendimi ; përmban 9 faqe, ka një strukturë të qëndrueshme, janë respektuar rregullat e drejtshkrimin, përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, fjalitë paraqiten me gjatësi mesatare dhe të kuptueshme. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar nga gjyqtarja në kryesekretarinë e gjykatës në datën 05.02.2016, pas 8 ditëve nga shpallja, brenda afatit të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile. Gjykimi i çështjes nga gjyqtarja është realizuar për 2 muaj e 25 ditë, në intervalin kohor 03.11.2015 – 28.01.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm (jo më tej se 6 muaj) të përcaktuar në Vendimin të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 6 seanca, 1 seancë përgatitore e cila ka qenë produktive dhe 5 seanca gjyqësore prej të cilave, 1 seancë ka qenë joproduktive pasi është shtyrë me kërkesë për shtyrje të përfaqësuesit të palës së paditur.
- Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 25 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm (jo më tej se 6 muaj), sipas Vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtarja. Seancat gjyqësore janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve ligjore.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat proceduralë të zhvillimit të gjykimit civil të themelit. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse, si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt dhe gjyqtarja rezulton që të jetë shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar, sipas një strukture të qartë dhe të organizuar në mënyrë logjike. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar duke analizuar pretendimet e palëve, në referim të dispozitave procedurale dhe materiale.

Dosja 10 (5) - Çështja familjare me nr. regjistri 1847, datë regjistrimi 09.09.2015, me palë paditëse P.S, palë e paditur V.S, me objekt “Zgjidhje martesë”, e përfunduar me vendimin nr. 1423, datë 05.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier më datë 09.09.2015, me numër regjistri 1847. Me shortin elektronik të datës 10.09.2015, i ka rënë për gjykim gjyqtares {...}. Më datë 10.09.2015 (në të njëjtën ditë të caktimit të çështjes me short) me vendimin “Për kalimin e çështjes në seancën e pajtimit”, gjyqtarja në përputhje me nenin 158/a të K.Pr.Civile dhe 134 të K.Familjes, ka disponuar me caktimin e seancës për veprimet e pajtimit për në datë 05.10.2015, ora 09.00, si dhe njoftimin e palëve. Më datë 05.10.2015, ora 09.00 është zhvilluar seanca e pajtimit. Gjykata, pasi ka verifikuar paraqitjen e palëve, ku prezent ka qenë paditësi dhe e paditura. Pasi janë pyetur nga gjykata për shkaqet dhe rrethanat në lidhje me zgjidhjen e martesës së tyre dhe pasi ka konstatuar se kërkesë padia është e plotë dhe se midis palëve nuk ka asnjë lloj mundësie pajtimi, bazuar në nenin 158/a, 158/b të K.Pr.Civile dhe 125 e vijim të K.Familjes, ka vendosur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore, duke caktuar datën 28.10.2015, ora 10.30, për zhvillimin e saj.

.....

Më datë 28.10.2015, ora 10.32, është zhvilluar seanca e parë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent në gjykim ka qenë paditësi, e paditura nuk është paraqitur pa asnjë shkak, nuk është paraqitur përfaqësuesi me deklarami i paditësit, i cili ka kërkuar të shtyhet seanca pasi nuk mund të vazhdojë pa prezencën e avokatit. Gjykata, bazuar në nenin 179/2, 171/a dhe 96/a i K.Pr.Civile, ka vendosur të vazhdojë gjykimin në mungesë të të paditurës si dhe të pranojë kërkesën e paditësit për të pasur të pranishëm avokatin e tij, duke shtyrë seancën gjyqësore për në datë 04.11.2015, ora 09.00. Më datë 04.11.2015, ora 09.13, është zhvilluar seanca e dytë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent në gjykim ka qenë paditësi dhe e paditura si dhe përfaqësuesit e tyre të legjitimuar nga gjykata, është vijuar me të gjitha hapat proceduralë si; shpallja e trupit gjykues, pyetja e palëve nëse kanë kërkesa paraprake, deklaramin e hapur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palës paditëse për të dhënë shpjegime dhe pas shpjegimeve të palës paditëse, e paditura ka dhënë prapësimet si dhe ka kërkuar kohë për të sjellë në formën e kërkuar nga ligji, aktet të cilat provojnë mbiemrin në aplikimet për dokumenta në shtetin Grek. Gjykata, ka pranuar kërkesën e përfaqësuesit të të paditurës për ti dhënë kohë për të sjellë në gjykim provën në formën e kërkuar nga ligji dhe për këtë shkak ka shtyrë seancën gjyqësore për në datë 05.11.2015 ora 12.15. Më datë 05.11.2015, ora 12.27, është zhvilluar seanca e tretë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent kanë qenë paditësi dhe përfaqësuesi i tij, e paditura dhe përfaqësuesi i saj nuk kanë qenë prezent, edhe pse kanë pasur dijeni për seancën, nuk kanë paraqitur shkak për mungesën dhe gjykata, pas pyetjes së paditësit, ka vendosur vazhdimin e gjyimit në mungesë për të paditurën. Gjykata, pasi ka cituar provat e palës paditëse, ka vendosur administrimin e tyre, ka pyetur palën nëse ka kërkesa të tjera në dobi të gjyimit dhe në kushtet kur nga pala paditëse nuk ka pasur kërkesa të tjera, ka vendosur ti japë fund hetimit gjyqësor dhe të ftojë palën paditëse për pretendimet përfundimtare. Pala paditëse, ka dhënë pretendimet përfundimtare dhe gjykata, pasi është tërhequr në dhomë këshillimi, në kthim ka shpallur vendimin duke vendosur pranimin e kërkesë padisë.

Vendimi përfundimtar me nr. 1423, datë 05.11.2015, është i organizuar në tre pjesët përbërëse: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi, vendimi përmban elementët e domosdoshëm, sipas parashikimeve të nenit 310 të K.Pr.Civile. Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues dhe sekretaren gjyqësore, kohën dhe vendin e zhvillimit të gjyimit, identitetin e palëve, si dhe përfaqësuesit tyre, objektin dhe bazën ligjore të padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palës paditëse, (në mënyrë të përmbledhur, në një fjali të vetme) dhe faktin që e paditura la zhvillimin e këtij gjykimi në mungesë. Pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimit organizohet në një strukturë unike, duke u ndarë në nënpjesë. Në fillim të arsyetimit, në nënpjesën të titulluar "Vëren", gjyqtarja ka analizuar kryesisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e çështjes si dhe faktin se gjykimi është bërë me një gjyqtar konform nenit 35/3 të K.Pr.Civile. Më tej, gjyqtarja përshkruan rrethanat e faktit që kanë rezultuar të provuara në gjykim. Në vijim gjyqtarja ndalet në deklaramet e secilit bashkëshort, duke cituar faktin se të dy bashkëshortët gjatë gjyimit kanë pranuar se marrëdhënia martesore ishte lëkundur dhe nuk mund të gjejë më rregullim, duke u shprehur dhe në lidhje me fajësinë, ku asnjë nga bashkëshortët nuk kërkuar të hetohen në lidhje me fajësinë. Në vijim, të arsyetimit të gjykatës, gjyqtarja citon dhe arsyeton në lidhje me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim në rastin konkret, duke u ndalur specifikisht dhe në nenin 146 të Kodit të Familjes, në kushtet kur paditësi kishte kërkuar të mbante mbiemrin e bashkëshortes, duke analizuar dispozitën ligjore, mbi faktet, rrethanat dhe provat të cilat kanë rezultuar të provuara gjatë gjyimit. Në përfundim, pas shqyrtimit të rrethanave të faktit dhe analizës juridike, gjykata ka konkluduar se kërkesë

padia e paraqitur nga paditësi, është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar. Në pjesën urdhëruese të vendimit referohet baza ligjore procedurale e materiale e vendimmarrjes (nenet 126, 306-309 të K.Pr.Civile dhe nenet 127, 132 dhe 146 të Kodit të Familjes), si dhe disponimin e gjykatës për pranimin e kërkesë padisë, disponimin në lidhje me mbiemrin pas martesë, disponimi për shpenzimet gjyqësore, si dhe e drejta e ankimit, afatin dhe gjykatën kompetente për ushtrimin e së drejtës së ankimit.

Nga pikëpamja formale, vendimi ; përmban 4 faqe, ka një strukturë të qëndrueshme, janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, fjalitë paraqiten me gjatësi mesatare dhe të kuptueshme. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar nga gjyqtarja në kryesekretarinë e gjykatës në datën 10.11.2015, pas 5 ditëve nga shpallja, brenda afatit të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile. Gjykimi i çështjes nga gjyqtarja është realizuar për 1 muaj e 25 ditë, në intervalin kohor 09.09.2015 – 05.11.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve familjare në gjykatën e shkallës së parë (jo më tej se 4 muaj) të përcaktuar në Vendimin të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 4 seanca, 1 seancë e pajtimit e cila ka qenë produktive dhe 3 seanca gjyqësore prej të cilave, 1 seancë ka qenë joproduktive pasi është shtyë me kërkesë të paditësit i cili kërkonte të ishte prezent në gjykim avokati i tij.
- Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 25 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve familjare në gjykatën e shkallës së parë (jo më tej se 4 muaj), sipas Vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtarja. Seancat gjyqësore janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve ligjore.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat proceduralë të zhvillimit të gjykimit civil të themelit. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse, si dhe përmbajnë arsyen e vendimmarrjes.
- Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt dhe gjyqtarja rezulton që të jetë shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse.
- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar, sipas një strukture të qartë dhe të organizuar në mënyrë logjike. Pjesa arsyetuese e vendimit është e strukturuar duke analizuar pretendimet e palëve, në referim të dispozitave procedurale dhe materiale.

Dosja 11 (6) - Çështja penale me nr. regjistri 584, datë regjistrimi 10.03.2016, me kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kundër të pandehurës Xh.I dhe të pandehurës R.I, akuzuar për veprën penale “Dhuna në familje”, e parashikuar nga neni 130/a/1 të K.Penal. Përfunduar me vendimin nr.615, datë 26.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 10.03.2016, me numër regjistri 584. Me shortin elektronik të datës 10.03.2016, i ka rënë për gjykim gjyqtarës {...}. Me

...

vendimin e datës 11.03.2016, (1 ditë pas caktimit të çështjes me short), duke respektuar afatin procedural të parashikuar nga neni 333 të K.Pr.Penale, çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtarja, duke caktuar seancën gjyqësore më datë 05.04.2016, ora 10.30, dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve.

Më datë 05.04.2016, ora 10.39, është zhvilluar seanca e parë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, ku prezent ka qenë prokurori, nuk është paraqitur e pandehura Xh.I, pasi fletëthirrja dërguar për njoftim është kthyer me shënimin "Kthehet, refuzon", prezent e pandehura R.I. Gjykata i ka dhënë fjalën prokurorit në lidhje me mungesën e të pandehurës Xh.I, i cili ka deklaruar se njoftimi i saj të bëhet nëpërmjet Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Fier. Gjykata, bazuar në nenin 342/2/3, ka vendosur të njoftojë të pandehurën Xh.I nëpërmjet Shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Fier dhe për këtë shkak ka shtyrë seancën gjyqësore për në datë 19.04.2016, ora 09.45. Më datë 19.04.2016, ora 09.56, është zhvilluar seanca e dytë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të paraqitjes së palëve, ku prezent në gjykim ka qenë vetëm prokurori, nuk është paraqitur e pandehura Xh.I dhe nga gjykata është konstatuar se nuk ka patur dijeni, pasi njoftimi nuk ka qenë i rregullt në kushtet kur është firmosur vetëm nga oficeri i policisë gjyqësore. Nuk është paraqitur e pandehura R.I, e cila ka pasur dijeni nga prezenca e saj në seancën e kaluar dhe nuk ka paraqitur shkak për mungesën. Gjykata, pasi ka pyetur prokurorin në lidhje me mungesën e të pandehurave, ka vendosur, bazuar në nenin 342/2/3 të K.Pr.Penale të ndërpresë seancën gjyqësore dhe konform nenit 351/1 të K.Pr.Penale, të deklarojë mungesën e të pandehurës R.I si dhe konform nenit 49/1 ti caktojë asaj mbrojtës kryesisht, gjithashtu, konform nenit 132/2 të K.Pr.Penale, ka urdhëruar njoftimin e të pandehurës Xh.I, nëpërmjet Shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Fier dhe për këtë shkak ka shtyrë seancën gjyqësore për në datë 04.05.2016, ora 15.30. Më datë 04.05.2016, ora 15.31, është zhvilluar seanca e tretë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të prezencës së palëve, ku prezent ka qenë vetëm prokurori, nuk është paraqitur e pandehura Xh.I, e cila përsëri nuk ka patur dijeni për seancën pasi njoftimi dërguar nuk është konfirmuar, nuk është paraqitur e pandehura R.I, e cila kishte paraqitur kërkesë për shtyrje të seancës. Gjykata ka vendosur të shtyjë seancën gjyqësore duke pranuar kërkesën për shtyrje të të pandehurës R.I si dhe me qëllim përsëritjen e njoftimit për të pandehurën Xh.I, për në datë 19.05.2016, ora 10.45. Më datë 19.05.2016, ora 10.57, është zhvilluar seanca e katërt gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent ka qenë prokurori, në mungesë të të pandehurës Xh.I e cila përsëri nuk konfirmohej marrja dijeni dhe në prezencë të të pandehurës R.I. Gjykata, pasi ka revokuar vendimin e gjykimit në mungesë për të pandehurën si dhe i ka caktuar mbrojtës kryesisht, ka vendosur të shtyjë seancën gjyqësore me qëllim njoftimin e të pandehurës Xh.I për në datë 03.06.2016, ora 09.00. Më datë 03.06.2016, ora 09.00, është zhvilluar seanca e pestë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të prezencës së palëve, ku prezent ka qenë prokurori, nuk është paraqitur e pandehura Xh.I, e cila përsëri nuk është konfirmuar marrja dijeni, nuk është paraqitur e pandehura R.I, prezent në gjykim ka qenë mbrojtësja e zgjedhur. Gjykata, në kushtet kur e pandehura Xh.I përsëri nuk ka pasur dijeni të rregullt, ka urdhëruar njoftimin e saj nëpërmjet Shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Fier si dhe ka urdhëruar njoftimin e Drejtorit të Policisë të Qarkut Fier, për mos zbatim të urdhrit të gjykatës nga ana e Shërbimeve të Policisë, duke shtyrë seancën për në datë 14.06.2016, ora 15.30. Më datë 14.06.2016, ora 15.33, është zhvilluar seanca e gjashtë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent ka qenë prokurori, e pandehura Xh.I dhe mbrojtësi i saj, e pandehura R.I dhe mbrojtësja e saj. Gjykata, pas shpalljes së trupit gjykues, pyetjes së palëve nëse kanë kërkesa paraprake, mbrojtësi i të pandehurës Xh.I, ka kërkuar kohë të njihet me materialet e dosjes penale. Gjykata, ka vendosur të pranojë kërkesën

⋮

e mbrojtësit të të pandehurës duke shtyrë seancën gjyqësore për në datë 29.06.2016, ora 11.30. Më datë 29.06.2016, ora 11.30, është zhvilluar seanca e shtatë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent kana qenë prokurori, e pandehura Xh.I dhe mbrojtësi i saj si dhe në mungesë të të pandehurës R.I për të cilën ishte marrë vendimi i gjyqimit në mungesë dhe mbrojtëses së saj, e cila kishte paraqitur kërkesë për shtyrje, sipas të cilës për shkak se ndodhej në një gjykim tjetër në Gjykatë të Apelit e kishte të pamundur paraqitjen në këtë seancë. Gjykata, ka pranuar kërkesën për shtyrje të mbrojtëses të të pandehurës R.I dhe për këtë shkak ka shtyrë seancën gjyqësore për në datë 14.07.2016, ora 11.30. Më datë 14.07.2016, ora 11.30, është zhvilluar seanca e tetë gjyqësore. Në këtë seancë, pas verifikimit të palëve, ku prezent kanë qenë të gjitha palët, pasi është revokuar vendimi i mungesës për të paditurën R.I, mbrojtësit e të pandehurave kanë kërkuar gjykim të shkurtuar në kushtet kur çështja mund të zgjidhej në gjendjen ku janë aktet. Gjykata, pasi ka deklaruar të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe pasi ka marrë gjeneralitetet e te pandehurave, i është dhënë fjala prokurorit në lidhje me kërkesën për gjykim. Prokurori ka lexuar kërkesën për gjykim dhe ka deklaruar se ishte dakord në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar. Gjykata, është tërhequr në dhomë këshillimi për tu shprehur në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe në kthim, konform nenit 404 të K.Pr.Penale ka vendosur të pranojë kërkesën për gjykim të shkurtuar për të pandehurat, duke cituar dhe vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 29.01.2003 dhe nenin 371/1 të K.Pr.Penale, duke urdhëruar bashkimin e fashikullit të procedimit penal dhe të akteve që ndodhen në fashikullin e prokurorit. I është dhënë fjala prokurorit, i cili ka kërkuar kohë për të paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim. Gjykata ka pranuar këtë kërkesë duke shtyrë seancën gjyqësore për në datë 26.07.2016, ora 10.45. Më datë 26.07.2016, ora 11.01, (seanca ka filluar 15 min me vonesë dhe nuk është relativuar shkakut i fillimit me vonesë) është zhvilluar seanca e nëntë gjyqësore. Në këtë seancë, pasi është verifikuar prezenca e palëve, ku prezent kanë qenë të gjitha palët, i është dhënë fjala prokurorit për të paraqitur pretendimet përfundimtare. Prokurori ka paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim, gjithashtu, dhe mbrojtësit e të pandehurave kanë paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim, dhe pasi i është dhënë fjala prokurorit për replikë, gjykata është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur vendimin përfundimtar.

Vendimi përfundimtar me nr. 615, datë 26.07.2016, është i organizuar në tre pjesët përbërëse: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Në tërësi, vendimi përmban elementët e domosdoshëm sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.Penale. Pjesa hyrëse e vendimit përmban të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjyqësor, identitetin e palëve, akuzën, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve. Pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimit organizohet në një strukturë unike, duke u ndarë në nënpjesë. Në fillim të arsytimit, në nënpjesën të titulluar “Vëren”, gjyqtarja, parashtron faktin e paraqitjes së kërkesës nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, ndaj të pandehurave, të akuzuara për kryerjen e veprës penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal. Gjithashtu, gjykata ka parashtruar faktin se të akuzuarat gjatë gjyqimit kanë kërkuar aplikimin e gjyqimit të shkurtuar, kërkesë për të cilën ka dhënë miratimin dhe prokurori. Gjykata, duke vlerësuar se çështja zgjidhet në gjendjen në të cilën ndodheshin aktet, bazuar në nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale, ka vendosur pranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar të kësaj çështje, bazuar dhe në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë me nr. 2, datë 29.01.2003. Më pas, vijohet me përshkrimin e përmbledhur të ngjarjes e cila përbën faktin penal objekt akuze dhe më pas me renditjen e provave mbi të cilat mbështetet fakti i provuar në gjykim. Më pas, gjykata vijon arsytimin, duke trajtuar, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, analizimin e elementëve

.....

të figurës së veprës penale “Dhunë në familje”. Arsyetimi i gjykatës vijohet, duke trajtuar cilësimin juridik të veprës penale, duke cituar dhe interpretuar dispozitën e Kodit Penal në lidhje me “Dhunën në familje”, duke analizuar, objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive, duke analizuar gjithashtu, rrethanat e kryerjes së veprës penale, me elementët e figurës së veprës penale, mbi bazën e tërësisë së provave të ndodhura në dosjen e gjykimit. Gjykata, në vijim, ndalet dhe trajton llojin e masës së dënimit, duke mbajtur parasysh, rrezikshmërinë e veprës penale, faktin se kjo vepër penale është kthyer ndër shqetësimet kryesore të komunitetit, faktin e kryerjes së kësaj vepre me dashje nga të pandehurat, shkallën e ardhjes së pasojave, si dhe moshën e të pandehurave, nivelin e tyre arsimor dhe gjendjen familjare. Gjyqtarja, duke u nisur nga rrezikshmëria e të pandehurave dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, citon dhe analizon nenin 59 të Kodit Penal, duke analizuar kushtet komulative të formës alternative të vuajtjes së dënimit. Gjithashtu, gjykata, shprehet në përfundim të arsytimit dhe në lidhje me shpenzimet procedurale, duke i’u ngarkuar solidarisht të pandehurave. *Pjesa e dispozitivit të vendimit është e qartë dhe e plotë, përmban bazën ligjore procedurale dhe materiale të vendimmarrjes (nenet 379, 384, 390, 393, 406, 485 të K.Pr.Penale, nenet 47, 48, 59, 130/a/1 të K.Penal), disponimet mbi deklarinimin fajtor të të pandehurave, duke përmendur nenin përkatës, aplikimin e uljes së 1/3 të dënimit, masën e dënimit me gjobë, afatin e shlyerjes së gjobës, disponimin për shpenzimet gjyqësore, si dhe përcaktimin e qartë për të drejtën e ankimit, gjykatën pranë së cilës mund të ushtrohet ankim, si dhe afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.*

Nga pikëpamja formale, vendimi ; përmban 9 faqe, ka një strukturë të qëndrueshme, janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, fjalitë paraqiten me gjatësi mesatare dhe të kuptueshme.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar nga gjyqtarja në kryesekretarinë e gjykatës në datën 29.07.2016, pas 3 ditëve nga shpallja, brenda afatit për të ushtruar ankim.

Gjykimi i çështjes nga gjyqtarja është realizuar për 4 muaj e 16 ditë, në intervalin kohor 10.03.2016 – 26.07.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale në shkallë të parë kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim (jo më tej se 9 muaj), të përcaktuar në Vendimin të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

KONKLUZIONE

- Janë zhvilluar gjithsej 9 seanca gjyqësore, prej të cilave 7 seanca kanë qenë jo produktive pasi janë shtyrë për shkak të mosrealizimit të njoftimit të të pandehurës (5 prej tyre) si dhe për shkak të kërkesave për shtyrje të mbrojtësve të të pandehurave (dy prej tyre).
- Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 16 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale në shkallë të parë kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim (jo më tej se 9 muaj).
- Çështja është menaxhuar në mënyrë korrekte nga gjyqtarja. Seancat gjyqësore janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 342, pika 2, të K.Pr.Penale.
- Gjykimi në tërësi është zhvilluar duke respektuar të gjithë hapat proceduralë të zhvillimit të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet ligjore procedurale për gjykimin e shkurtuar. Vendimet e ndërmjetme për drejtimin e seancës në çdo rast

.....
evidentohen qartë, referojnë bazën ligjore përkatëse, si dhe përmbajnë arsyen e vendimarrjes.

- Vendimi i arsyetuar përmban elementët e domosdoshëm të vendimit përfundimtar të dënimit, sipas parashikimeve të nenit 383 të K.Pr.Penale, sipas një strukture standarde që ndjek gjyqtarja, të qartë dhe organizuar në mënyrë logjike.

VLERËSIMI DHE PIKËZIMI PËR AFTËSITË E GJYQTARES SIPAS KRITEREVE TË VLERËSIMIT

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1-A Njohuritë ligjore.

1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :
“...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja kualifikon drejtë marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor (shih dokumentet 2 e 3 si dhe dosjes 3 e 4). I kushton rëndësinë e duhur identifikimit të kërimit të palëve, dëgjon kërkimet procedurale të tyre, shprehet në çdo rast me urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara. Zbaton me korrektesë procedurën e gjykimit të shkurtuar, kriteret për aplikimin e dispozitës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim neni 59 i Kodit Penal (shih dokumentin 1 e dosjet 1, 2). Zgjidh drejtë çështjet në gjykim, e për pasojë në disa raste, palët bien dakort me zgjidhjen e çështjes dhe nuk e kundërshtojnë vendimin e dhënë në gjykatat më të larta (shih dokumentin 3 e dosjet, 1, 2, 4 e 5). Në disa raste, sipas natyrës së çështjeve, i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese e ligjit organik të saj, vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, si dhe ndryshimeve ligjore procedurale penale (shih dokumentin 1 e dosjet 1, 2). Ajo

njeh parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i zbaton ato gjatë gjykimit, por nuk i përdor shprehimisht në tekstin e vendimeve përfundimtare....”.

Nga vëzhgimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, në çështjet e përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtarja ka njohje dhe zbatim korrekt të ligjit material civil/ penal si dhe dispozitave procedurale, të referuara në mbështetje të vendimeve të ndërmjetme, gjatë zhvillimit të seancave dhe në përfundim të tyre.

Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes. Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja në vendimet përfundimtare, në pjesën përshkruese arsyetuese, fillimisht paraqet ecurinë dhe elementë proceduralë, edhe kur nuk janë të diskutueshëm në rastin konkret, të tillë si; juridiksioni, kompetenca lëndore dhe tokësorë, përbërja e trupit gjykues - më një ose tre gjyqtarë, në vendimet civile kërkesat dhe disponimet e gjykatës për ndryshime, shtesë/pakësim të objektit të padisë, ato për ekzekutim të përkohshëm të vendimit apo sigurim padie, në vendimet për çështjet penale, ecurinë procedurale gjatë hetimit, kërkesat paraprake dhe vendimin e gjykatës në lidhje më to.

Në vijim, në një nëndarje të veçantë, gjyqtarja paraqet faktet e çështjes, civile ose penale, ashtu si kanë rezultuar të provuara gjatë gjykimit. Në këtë pjesë të arsyetimit gjyqtarja bën analizë të provave të marra në gjykim dhe të fuqisë së tyre provuese, në funksion të përcaktimit të konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes për çështjet civile, si dhe në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimit juridik, për çështjet penale.

Në lidhje me identifikimin e natyrës së çështjes. Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit konstatohet se gjyqtarja përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, duke përcaktuar shkaku ligjor të padisë, natyrën e mosmarrëveshjes me karakter civil, civil familjar, kërkesë civile apo penale. Gjyqtarja, pasi bën përcaktimin e saktë të natyrës së çështjes, identifikon dhe argumenton çështjet thelbësore objekt gjykimi, të cilat shërbejnë për zgjidhjen e çështjes.

Në lidhje me përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja identifikon qartë, citon ligjin e zbatueshëm, dhe interpreton dispozitat ligjore, të cilat kanë lidhje dhe referojnë drejtpërdrejtë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Në vendimet civile, evidentohet se gjyqtarja identifikon ligjin civil procedural dhe material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit Civil, por edhe ligjeve organike përkatëse. Në vendimet penale gjyqtarja identifikon dispozitat penale, procedural dhe material, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, përgjegjësisë penale dhe individualizimin e dënimit.

Në vendimet gjyqësore të vëzhguara, konstatohet një rast ku gjyqtarja ka evidentuar dhe analizuar një rast të konfliktit të normave ligjore, e konkretisht në vendimin penal nr. 545/2016, në lidhje me zbatimin e nenit 278 të Kodit Penal, pas ndryshimeve me ligjin nr. 144/2013, nr.98/2014 dhe Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.9/2016. Në këtë rast gjyqtarja ka analizuar dhe konkluduar në lidhje më përmbajtjen e normës së zbatueshme në rastin konkret.

⋮

Në tërësi, referuar të dhënave që evidentohen nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve dhe më pas të natyrës së çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt, citimin dhe analizën e normave respektive, në të cilat është bazuar vendimi i dhënë nga Gjykata.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :
“...Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit...Gjyqtarja {...} ka njohuri në të drejtën penale, ku kombinon rregullat e pjesës së përgjithshme me ato të pjesës së posaçme të Kodit Penal, si dhe kualifikon drejtë veprën penale (shih dokumentin 1 e dosjet 1, 2). Gjithashtu, ai ka njohuri edhe në të drejtën procedurale penale në gjykimin e kërkesave për vlefësim caktim mase sigurimi personal (shih dosjen 5). Dy nga tre dokumentet ligjore dhe dy nga pesë dosjet e vëzhguara, konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën civile, familjare dhe atë të punës dhe konkretisht, lidhur me detyrimin për shpërblimin e dëmit dhe fitimin e munguar (shih dokumentin 2), pakësimin apo heqjen e detyrimit për ushqim të caktuar (shih dokuemtin 3), me shpërblimin për vjetërsinë në punë (shih dosjen 3) si dhe kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv”

Në vendimet përfundimtare të gjyqtares identifikohet në mënyrë të qartë norma ligjore dhe në shumë raste paraqitet edhe teksti i dispozitës. Gjyqtarja në përgjithësi nuk bën interpretim abstrakt dhe të panevojshëm të dispozitës, por vetëm në rastet kur është në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete dhe analizës së fakteve, duke sjellë si rrjedhojë llogjike konkluzionin e arritur në lidhje me zbatimin e saj.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm. Në vendimet gjyqësore të vëzhguara, konstatohet se gjyqtarja jo vetëm citon dispozitën ligjore të zbatueshme, por në shumicën e rasteve ka analizuar dhe interpretuar atë në kuadër të fakteve të çështjeve objekt gjykimi, duke zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale dhe procedurale që gjejnë aplikim në çdo rast konkret. Nga vendimet civile të vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja citon gjithmonë, dhe interpreton kur e vlerëson së është e nevojshme, normën juridike që zbatohet në zgjidhjen e çështjes, e konkretisht ; nenet 127, 50, 132, 133 , 146, 161, 192, 197, 201, 207, 210 të Kodit të Familjes, nenet 138/3, 141, 143, 144, 145, 148, 152, 153, 155 të Kodit të Punës, nenin 191, 663

...
të Kodit Civil. Në vendimet *penale*, gjyqtarja interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e veprës. Gjyqtarja interpreton normën, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, si dhe duke i ndërthurur me faktet dhe provat e rezultuara gjatë gjykimit, në funksion të konkluzioneve të arritura. Në këto vendimi konstatohet se dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal, interpretohen për të katër elementët e figurës së veprës/ave penale konkrete në gjykim si edhe lloji dhe masa e dënimit për secilën vepër.

Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale. Në vendimet gjyqësore të vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja i kushton një vëmendje të veçantë, jo vetëm interpretimit të dispozitave ligjore materiale, por dhe dispozitave procedurale, në rastet kur kjo i shërben në zgjidhjen e çështjes konkrete. Në vendimet *civile* evidentohet se gjyqtarja interpreton dispozitat të K.Pr.Civile, e konkretisht ; nenet 609 dhe 610 që sigurojnë mjetet e mbrojtjes në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, legjitimin material aktiv dhe pasiv të palëve, nenin 317 në lidhje me dhenien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, nenet 450 dhe 451 në lidhje me ankimin dhe formën e prerë të vendimit, nenet 36 dhe 59 në lidhje me juridiksionin gjyqësor, dispozitat në lidhje me sigurimin e padisë dhe pezullimin e ekzekutimit nga përmbaruesi gjyqësor, dispozitat që kanë të bëjnë me kompetencën lëndore /tokësorë apo formimin e trupit gjykues, neni 105 në lidhje me përcaktimin dhe ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore. Në vendimet *penale* evidentohet se gjyqtarja citon dhe interpreton dispozita të K. Pr. Penale, e konkretisht nenet 228, 229, 230, 234, 252, 259 në kërkesat penale për vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurie, nenin 375 për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nenet 403, 404 dhe 406 në lidhje me gjykimin e shkurtuar, 485 në lidhje me shpenzimet procedurale.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës. Nga vendimet e vëzhguara evidentohet që gjyqtarja i zbaton në çdo rast parimet e përgjithshme të së drejtës, por pa përmendur shprehimisht elementë të tyre. Ndërkohë, nisur nga përmbajtja e vendimeve përfundimtare të vëzhguara, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejtë aspekte të parimit të procesit të rregullt ligjor në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, kontradiktoritetin, disponibilitetin e padisë nga pala paditëse në përcaktimin e objektit të padisë, etj.

Në lidhje me identifikimin dhe përdorimin e jurisprudencës relevante. Nga 11 vendimet e vëzhguara evidentohet referimi në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr.2/2003 në vendimet penale; nr. 545/2016, nr. 673/2016 dhe nr. 615/2016 si dhe në vendimin nr. 9/2016 të Gjykatës Kushtetuese.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë për të interpretuar ligjin në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

⋮

I-B Arsyetimi ligjor

I-B-a Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “...Vendimet gjyqësore përfundimtare plotësojnë elementët e përcaktuara në ligj, janë të ndarë në tre pjesë dhe janë të kuptueshëm. Pjesa hyrëse e vendimit ka qenë e plotë në çdo rast të vëzhguar. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe në përgjithësi i përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor...”

Vendimet përfundimtare të gjyqtarës janë në çdo rast të thjeshta, të lexueshme, të kuptueshme dhe konçize. Në veprimet për drejtimin e seancave gjyqësore dhe vendimet përfundimtare përdoret gjuhë e thjeshtë, e qartë, e kuptueshme dhe e drejtpërdrejtë.

Evidentohet respektimi i rregullave drejtshkrimore, gramatikore dhe të sintaksës. Në tekstet e vendimeve përdoren fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin. Evidentohet ndonjëherë edhe fjali të gjata, por që janë në funksion të mosndërprerjes së mendimit.

Organizimi dhe shprehja e mendimit në tekstet e vendimeve, gjuha e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë, e bën të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshëm për të gjithë lexuesit, arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Nuk evidentohet të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren. Në rast kur referon në institutet e së drejtës, në ato pak raste që mund të hasen në vendimet e vëzhguara, gjyqtarja i përmend në arsyetim duke i cituar në gjuhën shqipe dhe për të mos krijuar konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :
“...Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil (shih dokumentet 2 e 3 si dhe dosjet 3 e 4) apo kërkesat e legjislacionit procedural penal (shih dokumentin 1 e dosjet 1, 2 e 5). Subjekti i rivlerësimit duket që përdor të njëjtën strukturë në hartimin e vendimit. Vendimet gjyqësore përfundimtare plotësojnë elementët e përcaktuara në ligj, janë të ndarë në tre pjesë dhe janë të kuptueshëm. Pjesa hyrëse e vendimit ka qenë e plotë në çdo rast të vëzhguar....”.

Në aspektin strukturor, vendimet kryesisht kanë ndjekur një strukturë të mirë përcaktuar duke evidentuar qartë tri pjesët përbërëse të vendimit (pjesa hyrëse, arsyetimi, pjesa urdhëruese).

Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhëna të plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, objektin dhe bazën ligjore të padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në mënyrë të përmbledhur.

Në pjesën përshkruese-arsyetuese, në vendimet e vëzhguara ndiqet një strukturë e organizimit të vendimit, e cila fillon me përshkrimin e fakteve të çështjes objekt gjykimi, të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim, duke i përshkruar në mënyrë të përmbledhur dhe duke interpretuar dhe provat shkresore mbi të cilat mbështet faktet e referuara. Më pas vijohet me paraqitjen e pretendimeve dhe prapësimeve të palëve dhe me vlerësimin e gjykatës, ku merret në analizë ligji i zbatueshëm, elementët e tij në lidhje me faktet konkrete, duke i dhënë përgjigje pretendimeve të palëve. Në vijim të arsyetimit jepet konkluzioni i gjykatës për zgjidhjen e çështjes.

Në pjesën e dispozitivit në vendimet civile gjen pasqyrim disponimi i gjykatës për zgjidhjen e çështjes dhe shpenzimet gjyqësore, e drejta e ankimit, si dhe data e shpalljes së vendimit gjyqësor. Në vendimet penale gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me fajësinë, dënimin dhe vendin e ekzekutimit të tij për të pandehurin, shpenzimet gjyqësore, e drejta e ankimit, si dhe data e shpalljes së vendimit gjyqësor. Përsa i takon dispozitivit të vendimit, gjyqtarja përdor teknikën e listimit të disponimeve pa i numërtuar ato, që vështirëson referencat në rastin kur vendimi ka disa disponime.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “ Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

I-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :
“...Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor...Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në xjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe në to nuk ka gabime logjike apo ligjore. Në përgjithësi tipar i punës së saj është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetim të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina...niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cënuar nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor...Ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, ku në të gjitha rastet pasqyrohet saktë shkaku dhe baza ligjore (shih 5 dosjet)”.

Në vendimet gjyqësore të vëzhguara konstatohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të analizës dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore, shtjellon argumentat e gjykatës në mënyrë llogjike, duke paraqitur një analizë të plotë të fakteve të çështjes, së bashku me provat mbi të cilat ato mbështeten, si dhe paraqet argumentat në lidhje me bazueshmërinë ose jo të kërkimeve objekt gjykimi.

Në vendimet gjyqësore të vëzhguara evidentohet *analizimi* në mënyrë të detajuar i ; pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv kur është vendim gjyqësor si dhe *faktit të ngjarë pas dhënies* së tij, parashkrimin e ankimit për të kundërshtuar veprimet e përmbaruesit gjyqësor sipas nenit 610 të K.Pr.Civile, nenin 317 të K.Pr.Civile për dhënien e vendimit gjyqësor civil me ekzekutim të përkohshëm, rastet kur jepet dhe si zbatohet në çështjen konkrete, sigurimin e padisë, juridiksionin gjyqësor në rastet kur palët më marrëveshje kanë zgjedhur arbitrashin si mënyrë për të zgjidhur konfliktet mes tyre, kontratës për bashkimin e kompanive, kontratës kryesore dhe anekset e saj, të drejtës për shpërblim për vjetërsi në punë dhe konceptin e vijueshmërisë së marrëdhënies së punës, afatet e njoftimit dhe procedurën në zgjidhjen e këtyre marrëdhënieve nga ana e punëdhënësit në një zgjidhje individuale dhe atë kolektive, dallimin mes tyre, shkakun e justifikuar, ristrukturimin e ndërmarrjes sipas nenit 138 të Kodit të Punës, legjitimitetit aktiv të palës paditëse duke bërë dallimin mes personit juridik dhe përfaqësuesit të tij ligjor, detyrimin për ushqim të prindërit ndaj fëmijëve të mitur, nenin 207 të Kodit të Familjes dhe ndryshimin e rrethanave për heqjen apo ndryshimin e masës së këtij detyrimi, analizon elementët e veprave penale dhe nëse provohen ekzistenca e tyre në rastin në shqyrtim, analizon rastin kur i bën faktit penal cilësim të ndryshëm juridik nga ajo e paraqitur nga prokurori, zbatimin në kohë të ligjit në rastet kur ka patur ndryshime, ekzistencën e kushteve dhe ligjshmërinë e arrestit në flagrancë, nevojës për vendosjen e masave siguruese personale me karakter shtrëngues, kushtet dhe kriteret për vendosjen e një mase konkrete.

Gjyqtarja argumenton në mënyrë logjike lidhjen e fakteve të provuara në gjykim, me ligjin e zbatueshëm, kuptimin e tij nëpërmjet interpretimit dhe duke identifikuar lidhjen shkak-pasojë, mes faktit, ligjit dhe konkluzionit në zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i

plotë, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “ Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2. A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara në këtë proces, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues është bërë duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësimin dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :
“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga

gjqtarja {...} ka qenë në intervale kohore nga 2 ditë (shih dosjen 5) deri në 6 muaj e 23 ditë (shih dosjen 2). Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 6 muaj e 23 ditë ka qenë çështje penale themeli dhe në përfundim të gjykimit është disponuar me vendim themeli deklarimi fajtor i të pandehurve dhe dënimit me brugim (shih dosjen 2). Në 3 dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 4 muaj e 5 ditë (shih dosjen 1), 2 muaj e 22 ditë (shih dosjen 3) dhe 1 muaj e 26 ditë (shih dosjen 4). Nga vëzhgimi i 5 dosjeve është konstatuar se, si çështjet civile me palë kundërshtare, që ka gjykuar në përbërje të dhomës civile të seksionit të përgjithshëm, ashtu edhe për çështjet penale që ka gjykuar në përbërje të dhomës penale, si dhe çështjen penale për vlefësimin e caktimit të masës së sigurimit, është respektuar afati standard i gjykimit dhe afati ligjor (shih dosjet 1-5). Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit konstatohet se ato kanë zgjatur 6 muaj e 23 ditë (shih dokumentin 1), 2 muaj e 16 ditë (shih dokumentin 2) dhe 7 muaj 16 ditë (shih dokumentin 3). Në 2 nga 3 dokumentet ligjore të vëzhguar, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda afatit standard 9 mujor, caktuar nga pika 5 shkronja "a" dhe brenda afatit 6 mujor, pika 5 shkronja "e" të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, duke filluar llogaritjen e afatit nga data e regjistrimit të çështjes e dhënë që del nga vendimet e paraqitura. Çështja e dokumentit 3 është gjykuar jashtë afatit standard 4 mujor caktuar nga pika 5 shkronja "d", të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit".

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu edhe për çështjet civile në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 dosje të çështjeve të përzgjedhura me short, parashikohen afate ligjore gjykimi. Konkretisht për dosjen nr. 5, afati ligjor i shqyrtimit të çështjes përcaktohet në nenin 259/5 të K.Pr.Penale, ku kërkesa është shqyrtuar nga ana e gjyqtarit brenda këtij afati (brenda 48 orëve nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë).

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjes të analizuar më sipër, në të cilën parashikohet afat ligjor për përfundimin e saj, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës në lidhje me këtë tregues, duhet të pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 15 pikë.

•
•
•
•
•
•
•

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, është i njëjti konkluzion i cituar në treguesin e mësipër, për shkak se analiza e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet me afat ligjor dhe standard minimal kohor, është bërë së bashku në raport.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar vetëm 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja. Për 10 çështjet e përzgjedhura me short rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së, për 9 prej tyre (dosjet 1, 3, 4, 6, 7, 9, 10, 11) dhe jashtë standardit minimal kohor për 2 prej tyre, përkatësisht;

-Dosja 2- Çështja penale nr. 780/103 regj, datë 11.06.2015 regjistrimi, që i përket të pandehurve A.H dhe E.R, akuzuar për veprën penale “Dhunim banese në bashkëpunim”, e përfunduar me vendimin nr. 673, datë 27.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykimi i çështjes është realizuar për 6 muaj e 23 ditë, në intervalin kohor 04.03.2016 – 27.09.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është në tejkallim të standardit minimal kohor për gjykimet penale në shkallë të parë kur procedohet për kundërvajtje (jo më tej se 4 muaj), të përcaktuar në Vendimin të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

-Dosja 8 (3) - Çështja penale me nr. regjistri 532, datë regjistrimi 22.05.2014, me të dëmtuar akuzuese T.D, kundër të akuzuarës R.D, akuzuar për veprën penale të “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 59 e vijim të K.Pr.Penale, e përfunduar me vendimin nr. 193, datë 26.03.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykimi i çështjes është realizuar për 10 muaj e 4 ditë, në intervalin kohor 22.05.2014 – 26.03.2015. Kohëzgjatja e gjykimit është në tejkallim të standardit minimal kohor për gjykimet penale në shkallë të parë kur procedohet për kundërvajtje (jo më tej se 4 muaj), të përcaktuar në Vendimin të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Ndërsa, në lidhje me 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së për 2 prej tyre dhe jashtë standardit minimal kohor për 1 prej tyre. Koncretisht, për çështjen e cila ka zgjatur tej standardeve minimale kohore (Dokumenti 3), është i pamundur identifikimi i shkaqeve të

shlyrjeve të seancave gjyqësore, për shkak se në dosjen e rivlerësimit kalimtar administrohet vetëm vendimi i zgjedhur nga gjyqtarja dhe jo e gjithë dosja gjyqësore.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 10 çështjet dhe 3 vendimet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, vetëm 3 nga çështjet, gjykimi është realizuar në tejkallim të standardit minimal kohor, të cilat përbëjnë 23% të çështjeve tej standardit minimal kohor. Duke analizuar 2 çështjet të cilat rezultojnë se kanë përfunduar në tejkallim të standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së do të rezultonte se;

-Dosja nr. 2, e përfunduar me vendimin nr. 673, datë 27.09.2016, gjykimi është zhvilluar në intervalin kohor nga data 11.06.2016 – 27.09.2016, nga ku rezulton se gjykimi ka zgjatur 6 muaj e 23 ditë. Nga vëzhgimi i dosjes, rezulton se janë zhvilluar 10 seanca gjyqësore, 8 prej të cilave janë shtyrë për shkaqe të pavarura nga gjyqtarja dhe që nuk janë përgjegjësi e saj, të tilla si; *moskonfirmimit të marrjes dijeni të të pandehurve, njoftimin e mbrojtësit kryesisht, kërkimi i kohës së nevojshme nga ana e mbrojtësve për tu njohur me materialet e dosjes, mosparaqitja pa shkaqe të të pandehurit dhe të mbrojtësis si dhe mosparaqitja e prokurorit.* Gjithashtu, gjatë intervalit kohor të gjykimit, përfshihet dhe periudha e lejes vjetore gjatë muajit gusht.

-Dosja nr. 8, e përfunduar me vendimin nr. 193, datë 26.03.2015, gjykimi është zhvilluar në intervalin kohor nga data 22.05.2014 – 26.03.2015, nga ku rezulton se gjykimi ka zgjatur 10 muaj e 4 ditë. Nga vëzhgimi i dosjes, rezulton se janë zhvilluar 19 seanca, 11 prej të cilave janë shtyrë për shkaqe të pavarura nga gjyqtarja dhe që nuk janë përgjegjësi e saj, të tilla si; *me qëllim njoftimin e palëve, mungesa e prokurorit në gjykim, mungesa e mbrojtësit të të dëmtuarës akuzuese apo e mbrojtësit të të akuzuarës, mungesa për arsye shëndetësore e gjyqtares.* Gjithashtu, gjatë intervalit kohor të gjykimit, përfshihet dhe periudha e lejes vjetore gjatë muajit gusht.

Nisur nga analiza e mësipërme, rezulton përfundimisht se gjyqtarja ka gjykuar jashtë standardit minimal kohor, vetëm 1 nga 13 çështjet e analizuar, ose 7.7% të tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, është i njëjti konkluzion i cituar në treguesin “2.A.a Respektimi i afateve ligjore”.

⋮

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke i'u referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit⁶.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (*13 çështjet e marra në analizë (10 çështjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e zgjedhura nga gjyqtarja), janë; 3 çështje civile themeli, 3 çështje marrëdhënie pune, 2 çështje familjare dhe 5 çështje penale themeli (2 penale kundërvajtje dhe 3 penale themeli)*), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështjet në kategorinë e çështjeve "*Civile themeli*", rezulton të jetë 75 ditë (2 muaj e 15 ditë), pra më i shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile të karakterit të përgjithshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështjet në kategorinë e çështjeve "*Marrëdhënie pune*", rezulton të jetë 75 ditë (2 muaj e 15 ditë), pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile të karakterit të përgjithshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë (6 muaj).
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështjet në kategorinë e çështjeve "*Familjare me palë kundërshtare*", rezulton të jetë 140 ditë (4 muaj e 20 ditë), pra më e gjatë se standardi minimal për gjykimin e mosmarrëveshjeve familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë (4 muaj).
- (iv) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështjet në kategorinë e çështjeve "*penale kundërvajtje*", rezulton të jetë 240 ditë (8 muaj e 13 ditë), pra më e gjatë se standardi minimal për gjykimin e çështjeve kundërvajtjeve penale në Gjykatën e Shkallës së Parë (4 muaj).
- (v) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështjet në kategorinë e çështjeve "*penale krime*", rezulton të jetë 151 ditë (5 muaj e 1 ditë), pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale krimenë Gjykatën e Shkallës së Parë (9, 12 muaj).

Nga këto burime rezulton se kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor *për shumicën* e kategorive të çështjeve.

Ndërkohë, duke analizuar të dhënat statistikore për çdo çështje, sipas arsytimit të bërë dhe në treguesin më sipër 2.A.b, nga kjo periudhë duhet të zbriten, koha që i është dashur gjyqtarit për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej tij si njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve, pushimet vjetore gjatë muajit Gusht, si dhe festat zyrtare gjatë muajit Dhjetor dhe Janar.

Nisur nga kjo analizë, vlerësoj se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe për këtë arsye, gjyqtarja për këtë tregues duhet të vlerësohet në nivelin maksimal.

⁶ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: "*Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.*"

⋮

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “ Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, në seksionin civil e atë penal. Në Formularin e Vetëdeklarimit në rubrikën e të dhënave statistikore ajo ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim për periudhën 07.10.2013 – 07.10.2016, gjithësej 1252 çështje gjyqësore në cilësinë e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Për këtë periudhë ka deklaruar se ka përfunduar 1259 çështje gjyqësore. gjithashtu, ka deklaruar se ka mbartur gjithësej 87 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve si gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bazuar në këto të dhëna është 100%”.*

Nga të dhënat statistikore të administruara në dosje, për periudhën e vlerësimit, rezulton se: Gjyqtarja {...}, gjatë kësaj periudhe, sipas të dhënave statistikore, ka gjykuar gjithësej 1269 çështje, prej të cilave; civile të përgjithshme 224, familjare 76, kërkesa civile 255, penale themeli 225 dhe kërkesa penale 489.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit si dhe mospërputhje të numrit të çështjeve të përfunduara në bazë të të dhënave statistikore me të dhënat e pasqyruara në Raportin e analizimit të aftësive profesionale, mbetet e pamundur përllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 100 % i përcaktuar në faqen 34 të Raportit, faqe 1088 i dosjes së rivlerësimit.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtares për periudhën e plotë të vlerësimit rezulton në masën 100 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar.

Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve për 5 dosjet e vëzhguara është kryer për 2 ditë nga shpallja (shih dosjen 2), për 3 ditë nga shpallja (shih dosjen 5), për 4 ditë nga shpallja (shih dosjet 3, 4) dhe për 5 ditë nga shpallja (shih dosjen 1). Nga këto të dhëna rezulton se 2 vendimet gjyqësore civile (shih dosjen 3, 4) janë arsyetuar brenda afatit ligjor 10 ditor, një nga të cialt është ankimuar dhe është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe për shkak të rekursit çështja është ende në pritje për tu gjykuar në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu edhe vendimet e dosjeve penale 1, 2, e 5, duhet evidentuar se janë arsyetuar e dorëzuar brenda 2-5 ditë pas shpalljes së vendimit, brenda afatit 5 ditor dhe këto vendime nuk janë ankimuar nga palët në proces”.*

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- Dosja që i përket vendimit me nr. 545, datë 06.07.2016 është dorëzuar më datë 11.07.2016 (5 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 673, datë 27.09.2016 është dorëzuar më datë 30.09.2016 (3 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 1016, datë 20.07.2015 është dorëzuar më datë 24.07.2015 (4 ditë);

- Dosja që i përket vendimit me nr. 965, datë 10.07.2015 është dorëzuar më datë 14.07.2015 (4 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 424, datë 02.05.2014 është dorëzuar më datë 05.05.2014 (3 ditë);

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 14.04.2021, rezulton se:

- Dosja që i përket vendimit me nr. 1942, datë 26.12.2013 është dorëzuar më datë 06.01.2014 (10 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 615, datë 11.05.2015 është dorëzuar më datë 21.05.2015 (10 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 193, datë 26.03.2015 është dorëzuar më datë 31.03.2015 (5 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 95, datë 28.01.2016 është dorëzuar më datë 05.02.2016 (8 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 1423, datë 05.11.2015 është dorëzuar më datë 10.11.2015 (5 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 615, datë 26.07.2016 është dorëzuar më datë 29.07.2016 (3 ditë).

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit për kategorinë civile themeli, për 2 dosje (dosja 4 dhe 6) është 7 ditë, për kategorinë marrëdhënie pune, për 3 dosje (3, 7, 9) është 7 ditë, për kategorinë çështje familjare, për 1 dosje (10) është 5 ditë, për kategorinë penale kundërvajtje, për 2 dosje (2, 8) është 4, për kategorinë penale krime, për 2 dosje (1, 11) është 4 dhe për kategorinë kërkesa penale, për 1 dosje është 3 ditë. Referuar të dhënave, koha mesatare rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve ” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Ajo kryen veprime përgatitore, të cialt kanë qenë

efektive dhe i kanë shërbyer ecurisë së shpëjtë të gjykimit. Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 1 seanca (shih dosjen 1), me 10 seanca (shih dosjen 2), me 5 seanca (shih dosjen 3), me 10 seanca (shih dosjen 4) dhe me 1 seancë (shih dosjen 5). Këto të dhëna tregojnë që janë zhvilluar 37 seanca gjyqësore, nga të cilat 19 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 18 seanca joproduktive kanë qenë në 4 raste mospjesëmarrja prokurorit për shkak të qënies në seminar, gjykime të tjera apo veprime të ngutshme hetimore, në 2 raste kërkesa e avokates kryesisht për tu njohur me aktet si dhe në 12 raste kërkesa për shtyrje të palëve ndërgjyqëse, mbrojtësve të të pandehurve, apo moskonfirmimit të marrjes dijeni për seancën dhe qënies së palës pa mjet identifikimi...”.

Nga vëzhgimi i 10 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve civile themeli, marrëdhënie pune, familjare, penale krime, penale kundërvajtje, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, evidentohet si më poshtë:

Në çështjet e përzgjedhura me short administruar në dosjen e rivlerësimit:

Dosja 1, çështja me nr. regjistri 464, datë regjistrimi 18.01.2016, nr. vendimi 545, datë vendimi 06.07.2016. Janë zhvilluar **11 seanca gjyqësore**, prej të cilave 6 seanca kanë qenë jo produktive pasi janë shtyrë; me kërkesë për shtyrje të mbrojtësit dhe të të pandehurit, për shkak të mosparaqitjes së prokurorit.

Dosja 2, çështja me nr. Regjistri 780/103, datë regjistrimi 11.06.2015, nr. vendimi 673, datë vendimi 27.09.2016. Janë zhvilluar **10 seanca gjyqësore**, 8 prej të cilave kanë qenë jo produktive pasi janë shtyrë; për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit të të pandehurit, për shkak të mosmarrjes dijeni të të pandehurit, njoftimit të avokatit kryesisht, për ti dhënë kohë mbrojtësit për tu njohur me dosjen, si dhe për shkak të mosparaqitjes së prokurorit.

Dosja 3, çështja me nr. regjistri 1225, datë regjistrimi 27.04.2015, nr. vendimi 1016, datë vendimi 20.07.2015. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Dosja 4, çështja me nr. regjistri 1339, datë regjistrimi 14.05.2015, nr. vendimi 964, datë vendimi 10.07.2015. Janë zhvilluar **6 seanca gjyqësore**, prej të cilave 2 kanë qenë jo produktive pasi janë shtyrë me kërkesë të palëve për ti dhënë kohë për tu njohur me çështjen.

Dosja 6, çështja me nr. regjistri 1948, datë regjistrimi 23.09.2013, nr. vendimi 1942, datë vendimi 26.12.2013. Janë zhvilluar **7 seanca gjyqësore**, prej të cilave 3 seanca kanë qenë jo produktive pasi janë shtyrë me kërkesë për shtyrje nga pala paditëse si dhe për shkak të mosparaqitjes në punë të gjyqtarës për arsye shëndetësore.

Dosja 7, çështja me nr. regjistri 984, datë regjistrimi 11.03.2015, nr. vendimi 615, datë vendimi 11.05.2015, janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Dosja 8, çështja me nr. regjistri 532, datë regjistrimi 22.05.2014, nr. vendimi 193, datë vendimi 26.03.2015. Janë zhvilluar **11 seanca gjyqësore**, prej të cilave 10 seanca kanë qenë jo produktive pasi janë shtyrë për shkaqe si; mungesa e prokurorit në gjykim, mungesa e mbrojtësit tëët dëmtuarës akuzuese apo mbrojtësit të të akuzuarës, mungesa për arsye shëndetësore apo pjesëmarrja në konferencë e gjyqtarës.

Dosja 9, çështja me nr. regjistri 479, datë regjistrimi 03.11.2015, nr. vendimi 95, datë vendimi 28.01.2016. Janë zhvilluar **5 seanca gjyqësore**, prej të cilave 1 seancë ka qenë jo produktive, pasi është shtyrë me kërkesë të përfaqësuesit të palës së paditur.

⋮

Dosja 10, çështja me nr. regjistri 1847, datë regjistrimi 09.09.2015, nr. vendimi 1423, datë vendimi 05.11.2015. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, prej të cilave 1 seancë ka qenë jo produktive pasi është shtyrë me kërkesë të paditësit për të patur prezent në gjykim avokatin e tij.

Dosja 11, çështja me nr. regjistri 584, datë regjistrimi 10.03.2016, nr. vendimi 615, datë vendimi 26.07.2016. Janë zhvilluar **9 seanca gjyqësore**, prej të cilave 7 seanca kanë qenë jo produktive pasi janë shtyrë për shkakë si; mosrealizimit të njoftimit të të pandehurës (5 prej tyre) si dhe për shkak të kërkesave për shtyrje të mbrojtësve të të pandehurve (2 prej tyre).

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare, varion nga 2 seanca deri në 11 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 6.7 seanca gjyqësore.

Duke iu referuar seancave gjyqësore të çështjeve të trajtuara më sipër, rezulton se gjyqtarja ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme për shmangjen e seancave joproduktive, duke mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: përsëritja e njoftimit për të pandehurin, përsëritja e njoftimit për palën paditëse, etj. ndërsa, në çështjet penale gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore, duke respektuar në çdo rast ligjin procedural. Gjithashtu, gjyqtarja ka respektuar afatet e arsyeshme në caktimin e seancave si në rastet kur ligji ka parashikuar afate, duke i respektuar ato, ashtu dhe në rastet kur ligji nuk ka parashikuar afate të tilla.

Referuar sa më sipër, për treguesit e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangjen e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 10 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, edhe pse rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 6.7 seanca, *gjyqtarja ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangjen e seancave joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet, dhe për këto arsye duhet të pikëzohet maksimalisht.*

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “...Gjatë gjykimit, gjyqtarja {...} ka monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur vonesat në dërgimin e tyre apo për të siguruar zhvillimin korrekt të gjykimit. Ajo zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve, me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjyaktës. Orienton drejt debatit dhe hetimit gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve, diskutimin përfundimtar gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. për çdo kërkesë apo hap procedural, merr rregullisht mendimin e palëve në gjykim. Ajo i kushton rëndësi kërkimeve procedurale të palëve, në funksion të garantimit të pjesëmarrjes së plotë të palëve në proces dhe të dëgjimit të pretendimeve të tyre, si dhe kujdeset për të realizuar palët të drejtën e mbrojtjes apo përfaqësimit me avokat. Disponon me vendime të ndërmjetme të arsyetuara për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit”.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, evidentohet se: Ne 11 çështjet e përzgjedhura me short, 10 prej tyre i përkasin kategorive çështje civile dhe penale me palë kundërshtare dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak, përkatësisht këto çështje i përkasin kategorive; civile të përgjithshme, familjare me palë kundërshtare, marrëdhënie pune, penale krime, penale kundërvatje si dhe kërkesa në fazën e hetimit paraprak.

Gjyqtarja në të gjitha rastet i ka vënë në lëvizje çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore në çështjet civile dhe caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale, kryesisht brenda ditës ose pas 1 apo dy ditësh. Në çështjet penale, gjyqtarja ka respektuar afatin 10 ditor të parashikuar në nenin 333/1 të K.Pr.Penale, si dhe seancat përgatitore dhe ato gjyqësore, janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, duke u mbajtur në sistemin e regjistrimit audio apo nëpërmjet dokumentimit me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Në çështjet civile: rezulton që seancat gjyqësore të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre, relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni nga palët që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla, deklarin të hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave, marrjen në shqyrtim dhe administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat, deklarin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Në çështjet penale: Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal sipas parashikimeve të neneve 405 e vijues të K.Pr.Penale (në një

...

rast është proceduar me gjykim të shkurtuar) si dhe në një rast, duke respektuarafatin procedural të parashikuar nga neni 338 të K.Pr.Penale, në lidhje me caktimin e seancës së pajtimit. Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtarjakujdeset për relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve e të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, si dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, por në disa raste evidentohet fakti se seancat janë çelur me vonesa të pakonsiderueshme.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarës janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, duke respektuar të gjitha standartet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil apo penal në seancat gjyqësore të vëzhguara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “...Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Përgjithësisht aktet procedurale janë inventarizuar...”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes konstatohet se, aktet në dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e dosjes ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre. Renditja e akteve në dosje, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen

gjqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta nën aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarës renditja e akteve të dosjes gjyqësore është në atë mënyrë që e bën dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “..Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht nuk janë konstatuar mangësi në aftësitë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të...”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e paraqitura nga palët, aktet e hartuara nga gjykata (procesverbalet e seancës gjyqësore, vendimet gjyqësore, procesverbali audio). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet që dokumentacioni në dosje, është në përputhje me veprimet procedurale të kryera, nuk ka mungesa, dhe se është i duhuri.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit

·
·
·
·
·
·
·

100	Shkëlqyeshëm
-----	--------------

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kruterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3. A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të gjyqtarit me nr. 1086/4 prot, datë 01.12.2020 dhe kopjes së dosjes personale të gjyqtarit administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se; “Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013-8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur gjithësej 3 ankesa (1 në vitin 2014, 2 në vitin 2015) në Inspektoratin e KLD-së. 2 ankesat e vitit 2015, janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se ankesat zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta. Ndërsa, 1 ankesë e vitit 2014, është verifikuar për mosrespektim formal të ligji dhe është vendosur arkivimi ankesës pasi nuk rezultuan shkelje nga ana e gjyqtares. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë Gjyqësor ndonjë masë për procedim disiplinor”.

Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim, dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cënim të etikës apo përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtares, gjatë ushtrimit të funksionit.

⋮

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3. B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...} në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Lidhur me rezultatet e trajtimit të ankesave të nisur gjatë periudhës së vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe **nuk** rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integriteti të gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3. C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “..Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk

...
është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit..”.

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja, në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana gjyqtares.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton që gjyqtarja, të ketë përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit si dhe në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuarra të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “..Për vetë gjyqtaren {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve..”.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuarra të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

⋮

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A. a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, si gjatë veprimtarisë përgatitore e asaj gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.*

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët është e qartë, transparente dhe e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar pretendimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent, me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

⋮
Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, presumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve, apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtarës në këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Shumë i lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, presumohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësitë e gjyqtarës në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

⋮

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, prezumohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, si dhe vërtetimit me nr. 555/1 Prot., datë 20.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 18 trajnime që i përkasin periudhës së 3 viteve të fundit, me temat përkatëse si dhe u paraqitën më lart.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në cilësinë e pjesëmarrëses në 18 aktivitete trajnuese, në 29 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tri vjeçare.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 20 pikë.

⋮

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtaren nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues. Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se, *për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit*, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja, vlerësohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinsitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari të marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtaren nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues. Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se, *për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit*, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, **nuk** rezulton që gjyqtarja, gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja të vlerësohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI PËRGJITHSHËMI VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

•
•
•
•
•
•
•
•

